



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde




PLANIFIKIMI I PROKURIMIT



**MONITORIMI I PROCESIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT NË KOMUNAT:
DEÇAN, GJAKOVË, GJILAN, HANI I ELEZIT, JUNIK, PEJË, PRISHTINË,
RAHOVEC DHE VUSHTRRI**

Shtator, 2021

PLANIFIKIMI I PROKURIMIT



**MONITORIMI I PROCESIT TË PLANIFIKIMIT TË PROKURIMIT NË KOMUNAT:
DEÇAN, GJAKOVË, GJILAN, HANI I ELEZIT, JUNIK, PEJË, PRISHTINË,
RAHOVEC DHE VUSHTRRI**

Autor: Qëndrim Arifi

Monitorues: Arbenita Topalli, Arrita Reznici, Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është përgatitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO) me mbështetjen e USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse.

Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbatja

Lista e shkurtesave.....	7
1. Përmbledhje ekzekutive.....	8
2. Rreth projektit.....	11
3. Metodologjia.....	13
4. Baza ligjore në procesin e planifikimit të prokurimit.....	14
5. Rëndësia e planifikimit të prokurimit.....	14
6. Pasqyrë e përgjithshme e planifikimit të prokurimit.....	15
7. Planifikimi i prokurimit konform kërkesave ligjore.....	16
8. Komunat nuk përdorin formularin B01 të aprovuar nga KRPP, për Planifikim të Prokurimit.	19
9. Zbatueshmëria e planifikimit të aktiviteteve për furnizim.....	20
9.1. Komuna e Deçanit.....	20
9.2. Komuna e Gjakovës.....	21
9.3. Komuna e Gjilanit.....	23
9.4. Komuna e Hani Elezit.....	24
9.5. Komuna e Junikut.....	25
9.6. Komuna e Pejës.....	27
9.7. Komuna e Prishtinës.....	28
9.8. Komuna e Rahovecit.....	29
9.9. Komuna e Vushtrrisë.....	31
10. Numri i aktiviteteve të planifikuara për punë sipas planit të prokurimit dhe buxheti.....	32
11. Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020.....	34
11.1. Komuna e Deçanit.....	34
11.2. Komuna e Gjakovës.....	35
11.3. Komuna e Gjilanit.....	36
11.4. Komuna e Hani Elezit.....	36
11.5. Komuna e Junikut.....	37
11.6. Komuna e Pejës.....	37
11.7. Komuna e Prishtinës.....	38
11.8. Komuna e Rahovecit.....	39
11.9. Komuna e Vushtrrisë.....	39
12. Përputhshmëria e aktiviteteve afatgjate për punë 1-3 vjet me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunave.....	40
12.1. Komuna e Deçanit.....	40
12.2. Komuna e Gjakovës.....	41
12.3. Komuna e Gjilanit.....	42

12.4.	Komuna e Hani Elezit.....	43
12.5.	Komuna e Junikut.....	43
12.6.	Komuna e Pejës.....	44
12.7.	Komuna e Prishtinës	45
12.8.	Komuna e Rahovecit.....	46
12.9.	Komuna e Vushtrrisë	46
13.	Rëndësia e analizimit të tregut gjatë fazës së planifikimit të prokurimit	47
14.	Vlerësimi i tregut gjatë procesit të planifikimit.....	49
15.	Gjetjet lidhur me procesin e planifikimit të prokurimit.....	50
16.	Rekomandime	51
17.	Aneks I : Komentet e komunave të cilat nuk janë përfshi në raport	53
17.1.	Komuna e Hanit të Elezit.....	53
17.2.	Komuna e Junikut.....	55

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
INPO	Iniciativa për Progres
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
RrUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO) në kuadër të projektit “Kërkesa për Komuna Transparente dhe Llogaridhënese: Monitorimi i prokurimit publik dhe fuqizimi i qytetarëve për të sjellë ndryshime pozitive”, kanë monitoruar planifikimin e prokurimit për vitin fiskal 2020, përkatësisht implementimin e planeve përfundimtare të prokurimit të cilat komunat çdo vit janë të obliguara t’i hartojnë. Monitorimi përfshin nëntë komuna: Deçan, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Junik, Pejë, Prishtinë, Rahovec dhe Vushtrri. Gjatë monitorimit është analizuar nëse planet e prokurimit të hartuara nga komunat i përmbushin kriteret e kërkuara ligjore dhe në çfarë niveli janë zbatuar këto plane.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik,¹ së paku 30 ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrjeje publike, duhet të dorëzojë me shkrim te Zyrtaari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t’i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Ndërsa planifikimi përfundimtar i cili është monitoruar nga IKD/INPO në bazë të të njëjtit Ligj, kërkohet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrjeje publike duhet t’i dorëzojë Agjencisë Qendrore të Prokurimit (tutje AQP), një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon t’i prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Tutje, Ligji kërkon që planifikimi i prokurimit për kontrata të furnizimit, shërbimeve dhe punëve të jetë i detajuar.

Kërkesën ligjore që plani i prokurimit të dërgohet në AQP brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal e kanë zbatuar të gjitha komunat e monitoruara, përveç Komunës së Rahovecit, e cila Planin e ka dërguar më 06.03.2020, apo 13 ditë para se të miratohet Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020. Nga monitorimi nëse planet e prokurimit të komunave i përmbushin kërkesat ligjore rezulton se asnjëra komunë nuk e harton planin e prokurimit konform kërkesave të LPP-së, RrOUPP-it dhe Formularit B01.² Mangësitë më së shumti janë evidente tek aktivitetet për furnizim ku sasi dhe njësi për këto aktivitete nuk plotësohen fare nga komunat, ose edhe ato komuna që i kanë plotësuar, rezulton se të dhënat nuk janë të sakta. Përveç Komunës së Pejës, Prishtinës dhe Vushtrrisë, të cilat nuk kanë vendosur asnjë të dhënë rreth sasive apo njësi, komunat tjera janë munduar që t’i plotësojnë këto kërkesa, mirëpo gjatë hulumtimit rezulton që ato të dhëna janë të pasakta dhe kryesisht shabllone.

¹ Neni 8, paragrafi 1.

² Shih, neni 8, paragraf 2 të LPP-së <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>, lidhur me nenin 5 të RrUOPP https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/A01_Rregullat%20dhe%20Udhezuesi%20Operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf dhe Formular B01 <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

IKD dhe INPO kanë monitoruar pesë aktivitetet e para të prokurimit për furnizim që kanë iniciuar komunat e monitoruara, për të parë se a respektohet plani i prokurimit për aktivitetet për furnizime. Rezultatet e monitorimit dëshmojnë se në asnjërën komunë sasi të dhe njësi të nuk kanë qenë të njëjta si në plan ashtu edhe gjatë fazave tenderuese. Në fakt, vërehet që komunat kanë përdorur “shabllone” të ndryshme vetëm sa për t’i mbushur kolonat ku kërkohen sasi të dhe njësi të, sepse gjatë fazës tenderuese ajo njësi dhe sasi s’ka të bëjë fare me atë furnizim ose nuk është e vetmja, përkatësisht është shumë më e madhe. Pastaj, është analizuar nëse planet e prokurimit të komunave të monitoruara janë të bazuara në buxhet, respektivisht a kanë mbulueshmëri buxhetore për vitin 2020; IKD dhe INPO kanë krahasuar koston totale të projekteve për punë që kanë planifikuar komunat dhe buxhetin që kanë në dispozicion për vitin 2020.

Të gjeturat dëshmojnë se asnjëra nga komunat e monitoruara nuk e kanë vlerën e aktiviteteve të planifikuara të njëjtë me kapacitetet buxhetore që komuna ka në dispozicion për ato aktivitete. Përderisa Komuna e Vushtrrisë ka më shumë buxhet sesa vlera totale e aktiviteteve për punë të planifikuara, komunat e tjera kanë planifikuar projekte për punë pa pasur buxhet për zbatimin e tyre, përkatësisht kanë në dispozicion më pak buxhet se sa ai që kanë planifikuar me plan të prokurimit.

Monitorimi ka vazhduar me identifikimin në buxhetin 2020 të aktiviteteve për punë që komunat e monitoruara kanë planifikuar, pra është analizuar nëse aktivitetet e planifikuara për punë janë të identifikueshme në buxhet. Përveç Komunës së Vushtrrisë, ku të gjitha projektet për punë mund të identifikohen në buxhet, komunat tjera kanë projekte që fare nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, ndërsa Komuna e Gjilanit, Prishtinës dhe Pejës kanë kode të përgjithshme buxhetore të cilat pamundësojnë identifikimin e aktiviteteve të planifikuara në buxhet.

Objekt i monitorimit kanë qenë edhe pesë aktivitetet e para për punë që kanë iniciuar komunat, me kohëzgjatje një deri tre vite. Më saktësisht është monitoruar nëse financimi i këtyre aktiviteteve është i mbështetur në Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunave, përkatësisht Korniza a përgatitet konform kërkesave ligjore dhe kapaciteteve buxhetore të komunave.³ Komuna e Gjilanit dhe Rahovecit kanë të miratuar KAB-in me atë përmbajtje në të cilën nuk mund të identifikohen fare projektet kapitale. ndërsa Komuna e Deçanit asnjë nga projektet e identifikuar nuk i ka të parapara në KAB. Komuna e Gjakovës, Prishtinës dhe Vushtrrisë kanë nga një aktivitet i cili nuk mund të identifikohet në KAB. Në përgjithësi vërehet një mosrespektim i KAB-it gjatë fazave tenderuese lidhur me aktivitetet për punë me kohëzgjatje një deri tri vite.

IKD dhe INPO kanë analizuar mënyrat se si komunat e vlerësojnë tregun gjatë planifikimit të prokurimit dhe të gjeturat dëshmojnë se komunat kanë mangësi në vlerësimin e tregut dhe këto mangësi lidhen me metodat ose mënyrat e vlerësimit të tregut, përkatësisht kufizimi në vetëm një metodë vlerësuese dhe mosbashkëpunimi i kënaqshëm në mes zyrave të prokurimit dhe njërive kërkuese.

Rekomandohet që komunat të hartojnë planin e prokurimit ashtu siç kërkohet me LPP, RrUOPP dhe Formularin B01, përkatësisht komunat të sigurohen që në planifikimet e

³ Shih, neni 20, paragraf 2, i Ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, lidhur me nenin 5 të Ligjit 05/L -063, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-048 (2016) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524> / <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

ardhshme të aktiviteteve për furnizim përveç titullit të aktivitetit, datës se kur aktiviteti pritet të iniciohet dhe vlerës së parashikuar, në mënyrë të qartë dhe të saktë të vendosen artikujt, sasitë dhe njësitë. Ndërsa KRPP të sigurohet që Formulari B01 është adaptuar në platformën e-prokurimi në mënyrë që komunat të hartojnë planifikimin në bazë të kërkesave të formularit B01.

Komunat të sigurohen që planifikimi i prokurimit të jetë në bazë të kapacitetit buxhetor që ato kanë në dispozicion, përkatësisht vlera e parashikuar e aktiviteteve të planifikuara të jetë e njëjtë edhe në buxhet, sepse në të kundërtën rrezikohet iniciimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të planifikuara.

Korniza Afatmesme Buxhetore të hartohet në atë mënyrë që e njëjta të shërbejë si një dokument i cili siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve komunale dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Pra, ky dokument strategjik dhe i rëndësishëm duhet të hartohet në atë mënyrë që të gjejë zbatim në praktikë.

Komunat të kujdesen që gjatë procesit të hartimit të planifikimit të prokurimit, të bëjnë një analizë të mirëfilltë të tregut dhe kjo analizë të rezultojë në një vlerë të parashikuar sa më të afërt me vlerën reale të aktivitetit. Kjo mënyrë precize e analizimit mundëson që të kursehen mjete nga llogaritjet paushalle të vlerës së parashikuar dhe me këto mjete mund të planifikohet një aktivitet tjetër për komunën e caktuar.

2. Rreth projektit

Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e prokurimit publik në komunat në Kosovë vazhdon të mbetet e brishtë. Përkundër faktit se legjislacioni në fuqi në fushën e prokurimit publik përmbushë standardet e pranueshme për të zhvilluar aktivitetet e prokurimit publik duke u bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, në praktikë vazhdimisht cenohen këto parime, përfshirë transparencën, llogaridhënien, mos-diskriminimin, integritetin, etj.⁴

Konkretisht ka probleme të vazhdueshme në lidhje me planifikimin e vlerës së kontratave publike; shkelje të ligjit në lidhje me afatet e tenderit; publikimi i njoftimeve publike (lidhur me proceset e prokurimit) me gabime thelbësore dhe teknike; nënshkrimi i kontratave publike pa specifikuar datën e përfundimit të kontratave; shkelja e vlefshmërisë së sigurimit të ekzekutimit të kontratës, etj. Për më tepër, komunat në aktivitete të caktuara të prokurimit publik i kushtëzojnë operatorët me punësimin e ish-punonjësve të komunës.⁵

Punë e konsiderueshme duhet të bëhet për të parandaluar parregullsitë dhe korrupsionin gjatë fazës së prokurimit. Kosova duhet të adresojë kapacitetin e dobët të komunave për të administruar proceset e prokurimit publik, monitorimin e pamjaftueshëm, zbatimin e kontratave dhe sistemet e dobëta të mjeteve, të gjitha ato të cenueshme nga korrupsioni në rastin e prokurimit publik.

Andaj, përmes këtij projekti, IKD dhe INPO synojnë të adresojnë çështjet aktuale komplekse, siç u përmendën më lart, me të cilat po përballet prokurimi publik i Kosovës në nivel komune dhe rrjedhimisht të përmirësohet objektiviteti, transparenca, llogaridhënia, në komunat e Kosovës, përmes monitorimit të proceseve të prokurimit publik në nivel komune, si dhe duke siguruar pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proces, me fokus në nëntë komuna të zgjedhura: Vushtrri, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Gjilan, Junik, Deçan, Hani i Elezit dhe Rahovec.

Kjo bëhet përmes ekipit të ekspertëve, burimeve, si dhe përvojës së gjerë në këtë fushë, që është vënë në shërbim për aktivitetet e këtij projekti, duke realizuar një proces efektiv të monitorimit në nëntë komuna. Në fokus do të jetë fuqizimi i qytetarisë aktive përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese, si dhe përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në monitorimin e kontratave. Gjithashtu, rol kyç do të ketë adresimi i gjetjeve dhe rekomandimeve tek institucionet e nivelit qendror; fuqizimi i të sapodiplomuarve në drejtësi për të udhëhequr ndryshime pozitive në terren; duke promovuar praktika të mira të proceseve të prokurimit; dhe në fund duke rritur diskutimin, pjesëmarrjen, dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, OSHC-ve dhe qytetarëve.

Pikërisht roli aktiv i qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile është një faktor kryesor për të siguruar institucione më transparente, efektive dhe llogaridhënëse. Sa më shumë që qytetarët dhe OSHC-të të ndërgjegjësohen dhe të fuqizohen rreth rolit aktiv që ata mund të luajnë në monitorimin e punës së institucioneve dhe zvogëlimin e korrupsionit, aq më të qëndrueshme janë rezultatet. Prandaj, IKD dhe INPO i kanë kushtuar fokus të madh sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në monitorimin e kontratave, në seanca të buxhetit, etj. Përveç kësaj, IKD dhe INPO kanë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese ku qytetarët do të

⁴ INPO në partneritet me IKD, "Prokurimi i "përligjur" në Komunat e Kosovës", Prishtinë, 2019. f.8: <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Prokurimi-i-p%C3%ABrligjur-n%C3%AB-komunat-e-Kosov%C3%ABs.pdf>

⁵ Po aty, f.9.

mësojnë më shumë rreth rolit të tyre në proces, si dhe për rëndësinë që ka përfshirja e tyre në zvogëlimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Sa i përket rolit të qytetarëve, aktivitetet e projektit përfshijnë: sigurimin dhe lehtësimin e diskutimit ndërmjet qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur; duke siguruar që kërkesa e qytetarëve të përfshihet në procesin e planifikimit të prokurimit; promovimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve përmes veprimtarive të ndërgjegjësimit; sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në monitorimin e kontratave përmes vëzhgimeve, duke siguruar një kanal online ku qytetarët gjithmonë mund të adresojnë shqetësimet, problemet dhe pyetjet e tyre.

Për shkak të rrethanave të COVID-19, të gjitha aktivitetet e pjesëmarrjes së qytetarëve janë zhvilluar përmes platformave virtuale dhe metodave të tjera online.

Zbatimi i këtij projekti është realizuar në partneritet ndërmjet Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Iniciativa për Progres (INPO), të dyja organizata me përvojë të madhe në fushën e prokurimit publik.

Iniciativa për Progres është OSHC e trajnuar nga USAID përmes aktivitetit për Komuna Transparente, Efektive, dhe Llogaridhënëse. Kurse, IKD, në anën tjetër, ka një praktikë dhe përvojë të gjatë në monitorimin, identifikimin dhe, kur është e nevojshme, zbulimin e rasteve të keqpërdorimeve dhe diskriminimit në aktivitetet e prokurimit publik, sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes një sistemi të fortë monitorimi dhe hulumtimi.

3. Metodologjia

Me qëllim të hartimit të një raporti përmbajtësor dhe të bazuar në objektivat e projektit, IKD dhe INPO kanë përdorur kryesisht metodën e hulumtimit, analizës dhe metodën krahasuese. Objektivat e raportit kanë qenë që t'u jepet përgjigje pyetjeve: A është planifikimi i prokurimit në përputhje me buxhetin që ka në dispozicion komuna, vlerat e parashikuara të aktiviteteve të prokurimit gjatë fazës tenderuese a janë të njëjta si në planifikim, a është planifikimi i prokurimit në përputhje me kërkesat ligjore, a është planifikimi i kontratave për furnizim i njëjtë si në plan ashtu edhe gjatë procedurës tenderuese, a është dorëzuar plani i prokurimit përfundimtar brenda afatit të caktuar në AQP, a janë kontratat afatgjate 1-3 vjet në përputhje me Kornizat Afatmesme Buxhetore të komunave dhe a bëjnë komunat hulumtim apo analizë të tregut gjatë hartimit të planit të prokurimit dhe si e bëjnë atë. Analizimi i aktiviteteve për furnizim dhe për punë është bërë duke përzgjedhur pesë aktivitetet e para që kanë inicuar komunat në platformën e-prokurimi për vitin 2020, e gjithë kjo për të shmangur subjektivizmin.

Monitorimi është zhvilluar duke hulumtuar, analizuar e më pastaj krahasuar dokumentet si: Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik me plotësim-ndryshimet e tij, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, planet përfundimtare të prokurimit të komunave, Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, Kornizat Afatmesme Buxhetore të Komunave, Qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave etj. Gjithashtu, janë monitoruar edhe aktivitetet e prokurimit të komunave në platformën e-prokurimi me qëllim të identifikimit të projekteve të ndryshme të cilat kanë qenë në kuadër të objektivave të raportit. Në kuadër të hulumtimit, janë zhvilluar intervista me zyrtarët, përkatësisht udhëheqësit e zyrave të prokurimit të komunave dhe qëllimi i intervistave ka qenë ajo se si komunat e bëjnë vlerësimin e tregut gjatë fazës së planifikimit të prokurimit dhe si i arsyetojnë të gjeturat e raportit. Për shkak të pandemisë intervistat janë zhvilluar në mënyrë elektronike, përkatësisht nëpërmjet pyetjeve të dërguara me e-mail dhe përgjigjet janë pranuar në atë formë.

Të dhënat e grumbulluara janë analizuar dhe krahasuar dhe në fund janë vendosur në raportin i cili pasqyron planifikimin e prokurimit në nëntë komunat e monitoruara.

Përzgjedhja e projekteve për punë me kohëzgjatje 1-3 vite ka përfunduar më 19.11.2020 dhe ndryshimet eventuale për nga numri i aktiviteteve të zhvilluara pas kësaj date nuk pasqyrohen në këtë raport.

4. Baza ligjore në procesin e planifikimit të prokurimit

Planifikimi i prokurimit si një ndër dokumentet më të rëndësishme të prokurimit publik rregullohet me Ligjin për Prokurimin Publik, i miratuar në vitin 2011, i ndryshuar dhe plotësuar gjatë vitit 2014, dhe dy herë gjatë vitit 2016. Gjithashtu, planifikimi i prokurimit rregullohet edhe me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. Planifikimi i prokurimit bëhet për periudhën dymbëdhjetë mujore, respektivisht për vitin e ardhshëm fiskal, si një dokument i rëndësishëm se çfarë ka nevojë, përkatësisht çka planifikon të prokurojë autoriteti kontraktues gjatë periudhës së ardhshme dymbëdhjetë mujore.

Ligji e parasheh planifikimin e prokurimit që nga fazat fillestare të tij, respektivisht planifikimin paraprak, deri tek planifikimi përfundimtar i prokurimit. Ligji kërkon që “[j]o më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t’i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë.”⁶

Planifikimi duhet të bëhet në detaje të arsyeshme për kontratat për punë, shërbime apo furnizime.⁷ Përveç planifikimit paraprak, autoritetet kontraktuese duhet të hartojnë edhe një planifikim përfundimtar i cili duhet të dorëzohet në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (tutje AQP). Ligji kërkon që “[b]renda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t’i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal.”⁸

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (tutje: RrUOPP), përcaktojnë udhëzimet lidhur me planifikimin e prokurimit, ku planifikimi i prokurimit është hapi i parë në procesin e prokurimit, udhëzime lidhur me dobët e një planifikimi të mirë dhe pasojat fatale për autoritetet kontraktuese kur bëjnë një planifikim të dobët ose kur nuk bëjnë fare.⁹

Në këtë drejtim planifikimi i prokurimit është kërkesë ligjore që duhet përmbushur nga të gjitha autoritetet kontraktuese.

5. Rëndësia e planifikimit të prokurimit

Planifikimi i prokurimit përveç kërkesës ligjore, është edhe garancë e zbatimit të parimeve të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Planifikimi i mirë, konform nevojave reale të qytetarëve dhe mjeteve buxhetore që kanë në dispozicion autoritetet kontraktuese, është garancë se zhvillimi i procedurave të prokurimit do të jetë efikas, ku qytetarët do t’i marrin furnizimet, shërbimet dhe punët cilësore dhe aktivitetet e planifikuara të përfundojnë brenda

⁶ Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndyshimin Ligjit Nr. 05/L-068. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

⁷ Po aty, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

⁸ Po aty, neni 8, paragrafi 2, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

⁹ Për më shumë shih, Neni 5 i Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RrUOPP) <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhhezusi%2010%2004%202019%202.pdf>

afateve kohore. Në këtë drejtim planifikimi në bazë të asaj që e përcakton ligji është faktor kyç nëse një autoritet kontraktues do të jetë i suksesshëm apo do të dështojë në zhvillimin e procedurave të prokurimit për vitin e caktuar fiskal.

Planifikimi i prokurimit për vitin e ardhshëm fiskal mundëson që për prokurimet e ngjashme të përdoren procedura të përbashkëta, që mundëson një menaxhimin adekuat të kohës dhe kursimin e buxhetit të autoritetit kontraktues. Secila drejtori komunale në bazë të buxhetit që ka në dispozicion, duhet të planifikojë atë se çka do të prokurojë brenda vitit fiskal dhe të gjitha kërkesat grumbullohen në një dokument fillimisht paraprak e pastaj përfundimtar.

Plani i prokurimit dorëzohet në AQP brenda 15 ditësh pas miratimit të buxhetit për vitin e caktuar fiskal.¹⁰ AQP analizon prokurimet e përbashkëta për të gjitha autoritetet kontraktuese në mënyrë që t'i zhvillojë procedurat e prokurimit të përbashkëta.

Përmes planifikimit adekuat dhe profesional Autoritetet Kontraktuese (tutje: AK) eliminojnë mundësinë për situata të paparashikueshme që shpiejnë në prokurime emergjente. Në rastet e prokurimit emergjent imponohet përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme të cilat e eliminojnë dukshëm konkurrencën e lirë të tregut, si një parim shumë i rëndësishëm në fushën e prokurimit publik.¹¹

Së dyti, një planifikim i mirë do t'i grumbullonte të gjitha kërkesat e njëjësive brenda AK-së, të cilat pastaj do të prokuroheshin në mënyrë të planifikuar duke u anashkaluar mungesat e ndryshme brenda AK-së si dhe më e rëndësishmja do të kursehej paraja publike si pasojë e prokurimeve të shpeshta dhe të pakoordinuara brenda AK-së.

Së treti, planifikimi i prokurimit i përgatitur me kohë dhe në mënyrë profesionale do të identifikonte kërkesat e njëjta ose të ndërlidhura brenda AK-së, për të cilat do të udhëhiqej vetëm një procedurë e prokurimit apo procedurë e përbashkët, e gjithë kjo për faktin e efikasitetit në kohë dhe e ruajtjes së parasë që do të shpenzohej për prokurime të shumta për çështje të njëjta ose të ndërlidhura.

6. Pasqyrë e përgjithshme e planifikimit të prokurimit

IKD dhe INPO kanë monitoruar planifikimin e prokurimit në nëntë komunat e monitoruara, ku është pasqyruar për secilën komunë sa aktivitete për furnizime, shërbime, punë dhe konkurse projektimi ka planifikuar t'i zhvillojë gjatë vitit 2020 dhe sa para do t'i shpenzojë për zhvillimin e këtyre kontratave. Të dhënat në tabelë janë renditur sipas komunave të cilat në total kanë më së shumti aktivitete të planifikuara për vitin 2020. Të dhënat në tabelë dëshmojnë se Komuna e Prishtinës për vitin 2020 ka planifikuar gjithsej 205 aktivitete, Komuna e Gjakovës 123 aktivitete, Komuna e Pejës 115 aktivitete, Komuna e Vushtrrisë 68 aktivitete, Komuna e Hanit të Elezit 63 aktivitete, Komuna e Gjilanit 58 aktivitete, Komuna e Rahovecit 47 aktivitete, Komuna e Junikut 44 aktivitete dhe Komuna e Deçanit 30 aktivitete të prokurimit. Të dhënat i gjeni në tabelën numër I.

¹⁰ Shih neni Neni 8, paragrafi 2, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

lidhur me nenin 5, paragraf 7 i RrOUP-it. <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhezusi%2010%2004%202019%202.pdf>

¹¹ Për më shumë shih, po aty, neni 5, paragraf 4.

Planifikimi i prokurimit për komunat: Vushtrri, Gjakovë, Pejë, Prishtinë, Gjilan, Junik, Deçan, Hani i Elezit, Rahovec

Komuna	Furnizim		Shërbime		Punë		Konkurs Projektimi	
	N r.	Vlera €	Nr.	Vlera €	Nr.	Vlera €	N r.	Vlera €
Prishtinë	66	5,651,733.00	43	4,360,150.00	88	26,414,538.71	8	590,000.00
Gjakovë	43	1,354,806.00	27	1,768,426.48	53	6,970,082.00	/	/
Pejë	26	996,000.50	13	277,000.00	74	5,042,536.90	2	65,000.00
Vushtrri	35	830,180.90	19	1,432,015.00	14	725,985.30	/	/
Hani Elezit	13	83,765.80	22	191,034.15	28	591,772.00	/	/
Gjilan	29	967,639.55	12	1,297,943.20	16	4,947,998.18	1	62,157.00
Rahovec	10	239,323.50	11	470,248.00	26	1,040,000.00	/	/
Junik	17	86,985.00	14	285,654.00	12	575,467.00	1	30,000.00
Deçan	11	296,599.00	8	461,800.00	10	970,000.00	1	50,000.00

Tabela 1: Planifikimi i prokurimit për komunat: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Vushtrri, Hani i Elezit, Gjilan, Rahovec, Junik dhe Deçan¹²

Nga të dhënat në tabelë, rezulton se të nëntë komunat në total për vitin 2020 planifikojnë t'i zhvillojnë 250 aktivitete për furnizime me vlerë 10,506,010€, 169 aktivitete për shërbime me vlerë 10,544,271€, 321 aktivitete për punë me vlerë 47,278,380€ dhe 13 aktivitete për konkurs projektimi me vlerë 797,157€. Sipas këtij planifikimi komunat kanë paraparë shpenzime kryesisht në projekte kapitale, pasuar me shërbime, furnizime, ndërsa më së paku do të shpenzojnë për konkurse të projektimit.

7. Planifikimi i prokurimit konform kërkesave ligjore

Ashtu siç u theksua më lartë është kërkesë ligjore që brenda 15 ditësh pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Buxhetin, planifikimi përfundimtar i prokurimit të dërgohet në AQP.¹³ IKD dhe INPO kanë monitoruar nëse komunat kanë respektuar afatet kohore lidhur me dërgimin e planifikimit përfundimtar të prokurimit në AQP, të shtjelluar në tabelën më poshtë.

Dërgimi i planifikimit përfundimtar në AQP brenda afatit ligjor

¹² Burimi: Planifikimi përfundimtar i prokurimit të komunave: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Vushtrri, Hani i Elezit, Gjilan, Rahovec, Junik dhe Deçan.

¹³ Për më shumë shih, Neni 8, paragrafi 2, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

Komuna	Data e dërgimit në AQP	Brenda afatit Po/Jo
Deçan	20.03.2020	Po
Gjakovë	26.03.2020	Po
Gjilan	02.04.2020	Po
Hani i Elezit	27.03.2020	Po
Junik	02.04.2020	Po
Pejë	01.04.2020	Po
Prishtinë	02.04.2020	Po
Rahovec	06.03.2020	Jo ¹⁴
Vushtrri	03.04.2020	Po

Tabela 2: Dërgimi i planifikimit përfundimtar në AQP brenda afatit ligjor¹⁵

Hulumtimi ka rezultuar se përveç Komunës së Rahovecit, të gjitha komunat tjera kanë dërguar planifikimin përfundimtar të prokurimit brenda afateve kohore të parapara me Ligj. Komuna e Rahovecit¹⁶ rezulton që planifikimin përfundimtar të prokurimit e ka dërguar në AQP tetë ditë para se të miratohet Ligji nr. 07/I-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.¹⁷

Sipas ligjit, aktivitetet e prokurimit që planifikohen të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm fiskal duhet të parashikohen në detaje të arsyeshme.¹⁸ Në bazë të Formularit B01 të aprovuar nga KRPP, aktivitetet për furnizim duhet të përmbajnë të paktën të dhënat siç janë: njësia matëse, sasia e përafërt, çmimi për njësi dhe vlera e parashikuar, ndërsa aktivitetet për shërbime dhe punë, duhet të përmbajnë së paku vlerën e parashikuar dhe datën e planifikuar për iniciimin e aktivitetit.¹⁹ IKD dhe INPO kanë analizuar nëse planet e prokurimit përmbajnë të dhënat që kërkohen në dokumentin e planifikimit të prokurimit.

Përfshirja e të dhënave në plan të prokurimit (Po/Jo/Pjesërisht)			
Komuna	Furnizime	Punë	Shërbime

¹⁴ Komuna e Rahovecit Planin e prokurimit e ka dërguar në AQP para miratimit të buxhetit për vitin 2020.

¹⁵ Burimi: Planet përfundimtare të prokurimit.

¹⁶ Në bisedën telefonike me Zyrтарin e Prokurimit të Komunës së Rahovecit, z. Astrit Mullabazi, i njëjti është pyetur lidhur me këtë çështje dhe ka sqaruar se bëhet fjalë për një vendim që ka nxjerrë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (tutje KRPP) i cili i ka obliguar që planifikimin ta dorëzojnë para se të shpallet Ligji mbi përvetësimet buxhetore. INPO dhe IKD kanë kërkuar një dokument të tillë nga z. Mullabazi dhe pas ofrimit të tij vërejmë se i njëjti është thjeshtë një njoftim që autoritetet kontraktuese ta përgatisin planin e prokurimit konform kërkesave ligjore.

¹⁷ Ligji nr. 07/I-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

¹⁸ Shih neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1, I.2 dhe I.3 i Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

¹⁹ Formulari B01, KRPP <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

Deçan	Pjesërisht	Po	Po
Gjakovë	Pjesërisht	Po	Po
Gjilan	Pjesërisht	Po	Po
Hani i Elezit	Pjesërisht	Po	Po
Junik	Pjesërisht	Po	Po
Pejë	Jo	Po	Po
Prishtinë	Jo	Po	Po
Rahovec	Pjesërisht	Po	Po
Vushtrri	Jo	Po	Po

Tabela 3: Përfshirja e të dhënave në plan të prokurimit²⁰

Po: tek aktivitetet e furnizimeve do të thotë janë plotësuar të gjitha të dhënat e nevojshme përfshirë sasitë dhe njësitë, ndërsa tek aktivitetet për punë dhe shërbime do të thotë se janë plotësuar titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar dhe data e planifikuar e inicimit të aktivitetit.

Pjesërisht: tek aktivitetet për furnizim do të thotë se përveç titullit të aktivitetit, vlerës së parashikuar dhe datës së planifikuar të inicimit të aktivitetit janë të vendosura edhe sasitë dhe njësitë, mirëpo që këto të dhëna kryesisht nuk janë të sakta. Ndërsa tek aktivitetet për punë dhe shërbime, pjesërisht konsiderohet kur mungon njëra nga të dhënat, përkatësisht titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar ose data e inicimit të aktivitetit.

Jo: tek aktivitetet për furnizim do të thotë kur nuk është vendosur asnjë detaj lidhur me sasitë dhe njësitë. Ndërsa tek aktivitetet për punë dhe shërbime kur nuk është vendosur asnjë detaj.

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se asnjëra nga komunat nuk harton planifikimin e prokurimit në bazë të kërkesave ligjore, përkatësisht planet e prokurimit nuk janë të plotësuar me të dhënat të cilat duhet t'i përmbajnë në bazë të LPP-së, RrUOPP dhe Formularit B01. Ashtu siç shihet në tabelë, komunat nuk kanë arritur që planifikimin ta hartojnë konform kërkesave ligjore sidomos sa i përket aktiviteteve të planifikuara për furnizim. Në bazë të hulumtimit të IKD dhe INPO, tek aktivitetet për furnizim, komunat kryesisht vendosin shabllone tek njësitë dhe sasitë, pra, në parim disa komuna janë angazhuar që të hartojnë planin e prokurimit në bazë të kërkesave ligjore, mirëpo të dhënat e vendosura, përkatësisht sasitë dhe njësitë nuk janë të sakta. Ndërsa Komuna e Pejës, Prishtinës dhe Vushtrrisë për aktivitete të furnizimeve nuk e kanë vendosur asnjë detaj sa u përket sasive dhe njësieve ashtu siç obligohen me ligj.

Sa i përket të dhënave për aktivitetet për shërbime dhe punë, meqë edhe kërkesat e formularit B01²¹ të aprovuar nga KRPP nuk kanë kritere të larta, pra kërkojnë vetëm emërtimin e aktivitetit, vlerën e parashikuar dhe datën e inicimit, vërejmë se të gjitha komunat e kanë përmbushur si kërkesë.

²⁰ Burimi: Planet përfundimtare të prokurimit.

²¹ Për më shumë, shih legjislacioni sekondar KRPP, Formulari B01, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

8. Komunat nuk përdorin formularin B01 të aprovuar nga KRPP, për Planifikim të Prokurimit

Ligji²² e trajton çështjen e planifikimit të prokurimit dhe është i qartë tek kriteret që duhet t'i përmbajë Plani i Prokurimit. Në nenin 8, paragrafi 2 lidhur me nënparagrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të LPP-së, kërkesat janë që Plani i Prokurimit t'i përmbajë këto të dhëna "1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; 1.2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; dhe 1.3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal."

RrUOPP në nenin 2, paragrafi 1, nënparagrafi (a) thekson që qëllimi i RrUOPP është "[t]e plotësoj dispozitat e LPP-se dhe të përcaktoj specifikat dhe rregullat e proceseve elektronike të prokurimit publik." Tutje, në nenin 5 ku flitet për planifikimin e prokurimit definohet në mënyrë të qartë se "[p]lanifikimi i prokurimit është dokument me shkrim i cili tregon: a) Mallrat, punët dhe shërbimet e parashikuara të cilat do të prokurohen gjatë vitit fiskal; b) Datën e parashikuar të fillimit të procedurës; dhe c) Vlerën e parashikuar të kontratës."

Gjatë analizimit të Formularit B01 të aprovuar nga KRPP, vërejmë se i njëjti vetëm për aktivitetet e furnizimeve parasheh sasinë dhe njësitë, ndërsa për aktivitete të shërbimeve dhe punëve kërkohet vetëm emërtimi i aktivitetit, data e planifikuar e inicimit dhe vlera e parashikuar. Nëse e analizojmë Formularin B01, dhe formularët të cilët i përdorin komunat, vërejmë që ka mosrespektim të këtij formulari, përkatësisht asnjë nga komunat e monitoruara nuk ka përdorur formularin B01.²³ Ky mospërdorim është pasojë e platformës e-prokurimi, përkatësisht KRPP nuk ka arritur ta adaptojë formularin B01 edhe në platformën elektronike e-prokurimi dhe për pasojë komunat plotësojnë një formular tjetër. Formulari i cili përdoret nga komunat është i ndryshëm me Formularin B01, përkatësisht përveç te aktivitetet për furnizim parasheh sasi dhe njësi matëse edhe tek aktivitetet për shërbime dhe punë. Madje, Komuna e Gjilanit dhe Hanit të Elezit kanë plotësuar sasinë dhe njësitë edhe për aktivitetet

²² Shih, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 i Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>.

²³ Shih, Formularin B01 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

Shih formularët të cilët përdorin komunat:

Komuna e Prishtinës <https://prishtinaonline.com/uploads/rptplanskidokument.pdf>.

Komuna e Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2020/05/Planifikimi-i-prokurimit-2020.pdf>,

Komuna e Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/wp-content/uploads/sites/11/2020/04/Planifikimi-perfundimtar-i-vitit-2020.pdf>,

Komuna e Hanit të Elezit <https://kk.rks-gov.net/haniiielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/04/PlaniiProkurimit-2020..27.3.20.pdf>,

Komuna e Junikut <https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2020/12/Plani-i-Prokurimit.pdf>,

Komuna e Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/03/Planifikimi-Perfundimtare-i-Prokurimit-per-vitin-2020.pdf>,

Komuna e Gjakovës <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/04/Planifikimi-i-Prokurimit-2020.pdf>,

Komuna e Pejës <https://kk.rks-gov.net/peje/wp-content/uploads/sites/24/2020/04/PLANIFIKIMI-P%C3%8BRFUNDIMTAR-I-PROKURIMIT-PER-VITIN-2020.pdf>,

Komuna e Vushtrrisë <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/04/Planifikimi-Perfundimtar-i-Prokurimit-2020.pdf>.

për shërbime dhe punë, mirëpo sasi të dhe njësitë e vendosur janë vetëm shabllone sa për t'i plotësuar kolonat.

Përfundimisht, komunat e monitoruara nuk përdorin Formularin B01, për shkak se KRPP si organ kompetent për nxjerrjen e legjislacionit sekondar në fushën e prokurimit publik, nuk ka arritur që këtë formular ta adaptojë edhe në platformën elektronike.

9. Zbatueshmëria e planifikimit të aktiviteteve për furnizim

Plan i prokurimit për vitin e ardhshëm fiskal përveç që është i rëndësishëm të hartohet në bazë të kërkesave ligjore, është po aq e rëndësishme që i njëjti të implementohet nga ana e autoriteteve kontraktuese. IKD dhe INPO kanë testuar pesë aktivitetet e para për furnizim që ka zhvilluar secila komunë, për të parë nëse komunat qëndrojnë prapa planifikimit përfundimtar të tyre. Aktivitetet për furnizim janë monitoruar, përkatësisht testuar në atë se njësitë, sasi të dhe vlerat e parashikuara a janë të njëjta si në plan të prokurimit ashtu edhe gjatë hapjes së procedurës tenderuese.

9.1. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit për vitin 2020 ka planifikuar që të nënshkruajë gjithsej 11 aktivitete për furnizim me vlerë 296,599.00€. Pesë aktivitetet e para që ka iniciuar komuna për vitin 2020 kanë një vlerë totale të parashikuar 166,690.00€. Të dhënat lidhur me respektimin e Planit të prokurimit për aktivitetet për furnizim i gjeni në tabelën 4.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Deçanit						
Emri kontratës ²⁴	Plan			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizim me veshmbathje dhe material tjetër tekstili për shtëpinë e komunitetit	Copë	25	9,900.00	Palë Copë M	1364 687 175	9,900.00
Furnizim me material laboratorik	Copë	96	99,800.00	Pako Copë Litër	3273 10725 62	99,800.00
Furnizim me material stomatologjik dhe shpenzues për QKMF-Deçan	Copë	64	40,000.00	Pako Copë Scatul Kg Lit	963 4147 245 100 1,110	40,000.00

²⁴ Sqarim: Emrat e aktiviteteve të prokurimit kudo të përmendura në këtë raport, janë marrë në formën siç janë evidentuar në platformën e-prokurimi, apo në dokumentet zyrtare të komunave. Pra, emërtimi është ashtu siç e ka emërtuar komuna, pavarësisht gabimeve drejtshkrimore apo teknike.

Furnizim me artikuj ushqimor për shtëpinë e komunitetit në Deçan	Copë	66	9,999.00	Kg	6825	9,990,00
				Sc	900	
				Copë	5100	
				Litër	3015	
				Gr.	3000	
Furnizim me medikamente për shtëpinë e komuniteteve në Deçan	Copë	104	7,000.00	Sc	2054	7,000.00

Tabela 4: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Deçanit.²⁵

Të dhënat në tabelë tregojnë se Komuna e Deçanit vlerat e parashikuara të aktiviteteve për furnizim i ka konform Planit të prokurimit. Sa i përket vlerave lidhur me njësitë dhe sasi të të gjitha aktivitetet e testuara ka një dallim të madh në atë që është planifikuar me atë se çfarë njësi matëse dhe sasi janë evidentuar në fazat tenderuese. Komuna e Deçanit në asnjërin nga aktivitetet e paraqitura në tabelë njësitë dhe sasi nuk i ka të njëjta me Planin e prokurimit. Pra, Komuna nuk ka arritur që të planifikojë në detaje të arsyeshme aktivitetet për furnizim.²⁶ Në intervistën e zhvilluar me Shefin e Prokurimit z. Xhevdet Ramosaj lidhur me atë se pse njësitë dhe sasi dallojnë në Plan dhe gjatë fazave tenderuese, përgjigja ka qenë se sasia e artikujve të kërkuara është e llojeve të ndryshme dhe për shkak të platformës e kanë pasur teknikisht të pamundur që t'i specifikojnë secilën njësi dhe sasi.

9.2. Komuna e Gjakovës

Komuna Gjakovës për vitin 2020 ka planifikuar të shpenzojë një vlerë të konsiderueshme të buxhetit të saj për aktivitete të furnizimit, përkatësisht 1,354,806.00€. Është e rëndësishme të shikohet se ky shpenzim i mjeteve a bëhet konform planifikimit apo komuna gjatë fazave tenderuese nuk respekton Planin e prokurimit. Në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me atë se sa është respektuar Plani i prokurimit tek aktivitetet për furnizime.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Gjakovës						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizimi dhe montimi i ulëseve për parqe, kontenjerëve të vegjël për mbeturina, kapak të	Copë	1.000	120,000.00	Copë	870	119,600
				Kg	20,000	

²⁵ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/wp-content/uploads/sites/9/2020/05/Planifikimi-i-prokurimit-2020.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

²⁶ Për më shumë shih, neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

pusetave, dhe ujëmbledhsave-grila						
Furnizim me aparatura mjeksore dhe jomjeksore për nevoja të KPSH-së; Lëndët e prokurimit - Furnizim me aparatura mjeksore dhe jomjeksore për nevoja të KPSH-së, Blerja e aparaturave për Labarator, Bleraj e aparaturave të stomatologjisë	/	/	20,000.00	Copë	1,645	19,999.50
Furnizime mjekësore dhe jo mjekësore; Lëndët e prokurimit - Furnizim me barna emergjente, Furnizim me material hargjues dhe paisje stomatologjike, Furnizim me reagensa dhe material për laboratorin Biokimik-Hematologjik	/	/	70,000.00	Pako Komplet Copë Stk/pcs Kuti Flakon Kg. Litër Metër Rolne Shiringa Tubë Mililitër 20stk/pcs/ku ti 1x1,1000 2x1000l	2,830 524 141,125 20 667 269 165 245 30 267 45 493 126 15 40 8	70,000.00
Blerja e aparatit me rrymë të oksigjenit për nevoja të KPSH-së	Copë	/	10,000.00	Copë	15	9,900.00
Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit	/	/	28,000.00	Copë	114	19,980.00

Tabela 5: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, të aktivitetet për furnizim, Komuna e Gjakovës.²⁷

Nga pesë aktivitetet e monitoruara, vërejmë se vetëm në një aktivitet janë parapa sasitë, ndërsa njësia matëse në vetëm dy aktivitete të cilat edhe ashtu nuk përputhen fare me sasitë

²⁷ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Gjakovës <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/04/Planifikimi-i-Prokurimit-2020.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

dhe njësitë matëse gjatë fazës së tenderimit. Aktiviteti “Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit” vërehet se ka një tejkallim të madh të vlerës së parashikuar, në fakt vlera e parashikuar gjatë fazës tenderuese është shumë më e vogël se ajo që ishte planifikuar. Të gjitha këto janë tregues se Komuna nuk ka arritur që planifikimin e prokurimit ta bëjnë në bazë të kërkesave ligjore.²⁸ Lidhur me atë se përse nuk janë të vendosura për të gjitha aktivitetet për furnizim sasi të dhe njësitë, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit z. Faton Gutaj, është përgjigjur se këto detaje mund të gjenden gjatë procedurave tenderuese gjë që nuk është kontestuese në rastin tonë, sepse aty i kemi identifikuar, ndërsa gjithashtu ka potencuar që në planin e vitit të ardhshëm do të kujdesen që t’i përfshijnë edhe këto të dhëna që i kemi cekur. Sa i përket ndryshimit të vlerës së parashikuar, zyrtari në fjalë ka potencuar se kërkesa së bashku me vlerën e parashikuar vjen nga njësi kërkuese dhe se njësitë e kërkesës janë përgjegjëse për këtë çështje.²⁹ Dallimin në vlerën e parashikuar tek aktiviteti “Furnizim me mjete dhe paisje për shuarjen e zjarrit” z. Gutaj e ka sqaruar se kjo ndodhë për shkak se “për këtë aktivitet kanë qenë disa drejtori bashkë edhe një drejtori p.sh. Drejtorja e Administratës nuk ka marrë pjesë më, pra nuk ka pasë më nevojë për këtë aktivitet.” Pra, edhe kjo tregon për një planifikim të dobët sepse një drejtori fillimisht ka menduar që i duhet furnizimi i caktuar, mirëpo pastaj me kalimin e kohës ka rezultuar që nuk i duhet ai furnizim.

9.3. Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit për vitin 2020 ka planifikuar që pjesën më të madhe të buxhetit ta shpenzojë për aktivitete për punë dhe shërbime, ndërsa për aktivitete të furnizimeve planifikon të shpenzojë gjithsej 967,639.55€. Vlera e parashikuar e pesë aktiviteteve të para të vitit 2020 që ka iniciuar Komuna, kanë vlerë 128,125.00€. Këto dhe të dhënat tjera i gjeni në tabelën më poshtë.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Gjilanit						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizim me farë misri	/	/	/	Thasë	800	20,000.00
Furnizim me veshmbathje për puntorët e Komunës së Gjilanit	Komplet	1	10,760.00	Copë	325	32,125.00
Furnizim dhe mbjellja e drunjëve dekorativ	Komplet	1	20,000.00	Copë	1,700	20,000.00
Furnizim me lule dhe kurora per	Komplet	1	6,000.00	Copë	250	6,000.00

²⁸ Neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772> lidhur me nenin 5.6 i RrOUPP <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhezusi%2010%2004%202019%202.pdf>

²⁹ Sqarim: Njësitë e kërkesës në kuadër të komunës janë Drejtoritë Komunale.

Autoritetin Kontratues						
Furnizim me serra të zinguara	Komplet	I	50,000.00	Copë	30	50,000.00

Tabela 6: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Gjilanit.³⁰

Nga të dhënat në tabelë, vërejmë se Komuna e Gjilanit ka zhvilluar procedura të prokurimit për një aktivitet të furnizimit të cilën nuk e ka pasur fare në planifikim; bëhet fjalë për aktivitetin “Furnizim me farë misri” me vlerë 20,000.00€. Gjithashtu, aktiviteti “Furnizim me veshmbathje për puntorët e Komunës së Gjilanit”, ka dallim të theksuar në mes vlerës së parashikuar në Plan dhe asaj gjatë inicimit të aktivitetit. Edhe tek Komuna e Gjilanit vërehet përdorimi i shabllonit “komplet” tek njësia matëse dhe se i njëjti fare nuk është i aplikueshëm gjatë fazave të tenderimit. Kjo dëshmon se Komuna sasi të dhe njësitë e vendosura në Plan nuk i ka reale, mirëpo vetëm i ka plotësuar formalisht. Gjithashtu, Komuna e Gjilanit ka përdorur disa njësi që nuk njihen si njësi matëse siç janë: Thasë dhe set. Në intervistën me Menaxherin e Zyrës së Prokurimit z. Izet Kurteshi, i njëjti sa i përket dallimit ndërmjet vlerave të parashikuara, arsyetohet me atë se projektet mund të jenë të bashkuara në një projekt të njëjtë, gjë që, edhe po të qëndronte ky argument, përsëri mund të përfundojmë që Komuna e Gjilanit ka mangësi në planifikimin e aktiviteteve për furnizim.

9.4. Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit gjatë vitit 2020, ka planifikuar t’i zhvillojë gjithsej 13 aktivitete të prokurimit të llojit furnizime me një vlerë totale 83,765.80€. Aktivitetet e përzgjedhura, faktikisht pesë aktivitetet e para që ka iniciuar kjo Komunë kanë vlerë të parashikuar 44,973.00€, apo 54% e të gjithë buxhetit të planifikuar për furnizime. Të dhënat i gjeni në tabelën 7.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Hanit të Elezit						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizim me pije për Zyrën e kryetarit, kuvendin komunal, administratën komunale	/	/	/	Copë	33,690	9,997.00
Botimi i vjetarit dhe materialit shtypes etj.(Furnizime për zyre)	Kont	1,00	14,959	Copë	7,105	6,000.00

³⁰ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/wp-content/uploads/sites/11/2020/09/RIPLANIFIKIMI.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

Furnizim me material higjienik(Furnizime pastrimi)	Kont	1,00	6,523.20	Copë	8,223	8,990.00
Furnizim me maska, doreza, dezinfektues, rroba per dezinfektim etj.	/	/	/	Copë Palë Pako	8820 400 200	9,990.00
Furnizim me pajisje per kabinete	/	/	/	Copë	6	9,996.00

Tabela 7: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Hanit të Elezit.³¹

Nga të dhënat në tabelë, vërejmë se Komuna e Hanit të Elezit nga pesë aktivitetet e monitoruara, vetëm dy nga to figurojnë në Plan të prokurimit, ndërsa tri tjera janë zhvilluar pa qenë fare të planifikuara. Gjithashtu, Komuna e Hanit të Elezit, edhe pse në aspekt formal i kanë plotësuar planet e prokurimit, pas analizimit të pesë aktiviteteve vërehet që në Plan të prokurimit kanë përdorur tek njësia matëse shabllonin “kont” , ndërsa tek sasia “1,00”, të cilat fare nuk përputhen me njësitë dhe sasi të gjatë fazës tenderuese. Dy aktivitetet e inicuar të cilat mund të identifikohen në Plan të prokurimit, nuk kanë gjithashtu vlerë të njëjtë të parashikuar, gjë që dëshmon se Komuna e Hanit të Elezit ka dështuar që t’i qëndrojë prapa planifikimit që vetë ka hartuar sa i përket aktiviteteve për furnizim.

Në intervistën e zhvilluar me Menaxherin e Prokurimit të Komunës së Hanit të Elezit z. Xhevdet Bushi, sa i përket shabllonit “kont” dhe “1” i njëjti ka sqaruar se kont do të thotë kontingjent dhe në planifikim i vendosin ashtu, pastaj gjatë fazës së inicimit planifikohen në detaje. Sa i përket projekteve të cilat fare nuk figurojnë në planifikim e që janë inicuar, z. Bushi ka sqaruar se aktiviteti “Furnizim me maska, doreza, dezinfektues, rroba per dezinfektim etj.” nuk ka mundur të planifikohet sepse është zhvilluar në kuadër të masave mbrojtëse kundër pandemisë Covid-19, ndërsa për aktivitetet “Furnizim me pajisje per kabinete” dhe “Furnizim me pije për Zyrën e kryetarit, kuvendin” i njëjti ka ofruar një dokument, përkatësisht tabelë me projekte ku figurojnë edhe këto aktivitete, mirëpo ky dokument nuk është zyrtar dhe hulumtimi i IKD dhe INPO është i mbështetur në dokumente zyrtare, përkatësisht Plani përfundimtar i prokurimit i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 i ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në faqen zyrtare të komunës.³²

9.5. Komuna e Junikut

Komuna e Junikut, për vitin 2020 ka planifikuar t’i shpenzojë gjithsej 86,985.00€ për aktivitete të furnizimit. Përgjatë konkurset e projektimit, Komuna e Junikut do të shpenzojë më së paku për aktivitete të furnizimit, ndërsa pesë aktivitetet e përzgjedhura për monitorim kanë vlerë 60,090.00€. Të dhënat i gjeni në tabelën numër 8.

³¹ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Hanit të Elezit <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/04/PlaniiProkurimit-2020..27.3.20.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

³² Shih versionin zyrtar të planit të prokurimit të Komunës së Hanit të Elezit <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/wp-content/uploads/sites/37/2020/04/PlaniiProkurimit-2020..27.3.20.pdf>

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Junikut						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Blerja e Automjeteve për nevoja të komunës	Copë	1	30,000.00	Copë	1	30,000.00
Furnizim me dru për shkollat e Komunës së Junikut	Copë	1	9,000.00	M3	340	7,200.00
Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut	Copë	1	10,000.00	Copë	1	9,900.00
Furnizim me klima për objektin e QKMF	/	/	/	Copë	8	3,040.00
Furnizime mjekësore për QKMF- në, Dr. Ali Hoxha	Copë	1	9,950.00	Copë	24,045	9,950.00
				Kg.	2	
				Komplet	2	

Tabela 8: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Junikut.³³

Nga tabela më lart vërejmë se dy nga pesë aktivitetet e testuara nuk kanë njësi dhe sasi të njëjtë, respektivisht nuk i kanë ashtu siç janë planifikuar me Plan të prokurimit. Gjithashtu, dy nga pesë aktivitetet nuk kanë vlerë të njëjtë të parashikuar, pra, vlera e tyre dallon nga planifikimi me atë në fazën tenderuese. Tek kjo komunë në Plan të prokurimit, në vend të sasisë vërehet përdorimi i shabllonit “1”, pra numrit një që lë të kuptohet që sasia është 1, mirëpo kjo bie poshtë dhe vërtetohet me faktin se ky është një shabllon sepse tek aktiviteti “Furnizim me dru për shkollat e Komunës së Junikut”, në planifikim sasia është 1, ndërsa gjatë fazës tenderuese sasia është 340 m'. Pra, shablloni “1” është përdorur vetëm për të mbushur kolonat.

Aktiviteti “Furnizim me klima për objektin e QKMF” të cilën e ka inicuar komuna e Junikut nuk është fare në Plan të prokurimit. Lidhur me këtë çështje, Udhëheqja e Prokurimit znj. Florinda Maloku është përgjigjur se “Njësitë e Kërkesës nuk e kanë paraparë si aktivitet primar” dhe se “kjo ka ardhur si pasojë e pandemisë Covid-19 për të krijuar kushte më të mira për staf dhe pacientë.” Këto të gjetura janë tregues që Komuna e Junikut nuk ka arritur që gjatë planifikimit të prokurimit për aktivitete për furnizim ta zbatojë në përpikëri Ligjin për

³³ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Junikut <https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2020/12/Plani-i-Prokurimit.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

Prokurimin Publik, i cili kërkon që planifikimet për furnizimet e ardhshme të bëhet në detaje të mjaftueshme.³⁴

9.6. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës nga shuma e përgjithshme e buxhetit të planifikuar me Plan të prokurimit për vitin 2020 me vlerë 6,380,537.40€, për aktivitete për furnizim planifikon të shpenzojë gjithsej 996,000.50€. Aktivitetet që janë monitoruar kanë vlerë të planifikuar 198,208.00€ apo 19% e buxhetit të planifikuar për këtë kategori. Në tabelën më poshtë i gjeni informatat lidhur me atë se sa Komuna e Pejës e ka respektuar Planin e prokurimit për aktivitetet e furnizimit.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Pejës						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizim me filma digjital dhe reagenca për nevojat e QKMF- së LOT 1- Furnizimi me rreagenca për nevojat e laboratorit në QKMF LOT 2 – Furnizim me filma digjital për kabinetin e Diagnostikes në QKMF	/	/	5,000.00	Pako Copë	325 2,358	12,113.00
Furnizimi me rreagenca për nevojat e laboratorit në QKMF RITENDER	/	/	8,000.00	Litër Mililitër Copë Pako	300 2,000 56 420	7,363.00
Furnizimi me artikuj elektrik për nevojat e drejtorateve të SHCK-së	/	/	26,000.00	Copë m'	3,590 1,200	32,295.00
Furnizim me lënd djegëse - dru për ngrohjen e institucioneve arsimore	/	/	180,000.00	m2	3,829,8	180,000.00
Furnizim me artikuj Hixhenik dhe Ushqimor	/	/	55,000.00	Rollne Copë Paketim Palë Pako Kg.	5,400 10,590 1,100 1,000 1,100 6,260	52,000.00

³⁴ Shih, neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1 , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

				Gr.	5,500	
				Tufë	100	
				Litër	6,650	

Tabela 9: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Pejës.³⁵

Fillimisht aktiviteti “Furnizim me filma digjital dhe reagenca për nevojat e QKMF- së LOT I- Furnizimi me rreagenca për nevojat e laboratorit në QKMF LOT 2 – Furnizim me filma digjital për kabinetin e Diagnostikes në QKMF” nuk ka mundur të identifikohet i plotë në planifikim të prokurimit, në fakt është identifikuar aktiviteti “Furnizim me filma digjital për kabinetin Radiologjik Mamografi” me vlerë 5,000.00€. Gjithashtu, aktiviteti “Furnizim me artikuj “Hixhenik dhe Ushqimor” është aktivitet i bashkuar, përkatësisht në planifikim janë të ndarë si aktivitete, veçmas “Furnizim me artikuj ushqimor” me vlerë 25,000.00€ dhe “Furnizim me artikuj higjienik” me vlerë 30,000.00€. Të gjeturat në tabelën më lart tregojnë se në asnjërin nga pesë aktivitetet e monitoruara nuk janë të caktuara njësitë dhe sasi të për aktivitetet e planifikimit, e që në fakt komunat janë të obliguara që planin e prokurimit ta bëjnë në detaje të arsyeshme për furnizimet e ardhshme.³⁶ Gjatë fazës tenderuese, gjithashtu vërehen disa njësi matëse të panjohura apo inekzistente si për shembull: rollne, paketim, tufë. Lidhur me atë se pse disa aktivitete vlerën e parashikuar në Plan nuk e kanë të njëjtë me vlerën e parashikuar në inicim, Menaxheri i Prokurimit z. Xhemë Berisha është përgjigjur se këtë e vlerësojnë njësitë e kërkesës dhe mund të jetë për arsye të rritjes ose zvogëlimit të kërkesave nga komuniteti. Sa i përket mos vendosjes së sasive dhe njësive, i njëjti është deklaruar që përkundër përpjekjeve të vazhdueshme që të bëhet një gjë e tillë, kjo po pamundësohet për shkak të ndryshimit të rrethanave në kohën e hartimit të planifikimit dhe në kohën e inicimit.

9.7. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës, pas aktiviteteve për punë, një pjesë të konsiderueshme të buxhetit do ta shpenzojë për aktivitete të furnizimit, përkatësisht për vitin 2020 planifikon të shpenzojë gjithsej 5,651,733.00€. Pesë aktivitetet e para për furnizim të cilat janë iniciuar, kapin një vlerë të parashikuar prej 162,000.00€. Këto dhe të dhëna tjera i gjeni në tabelën numër 10.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Prishtinës						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizim me material higjienik për institucionet arsimore	/	/	50,000.00	Copë Litër Kg.	10,330 2,500 80	50,000.00
Furnizimi me pajisje teknologjike për	/	/	100,000.00	Copë	96	11,400.00

³⁵ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Pejës <https://kk.rks-gov.net/peje/wp-content/uploads/sites/24/2020/04/PLANIFIKIMI-P%C3%8BRFUNDIMTAR-I-PROKURIMIT-PER-VITIN-2020.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

³⁶ Për më shumë, shih, neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

nevojat e Komunës së Prishtinës						
Furnizimi dhe montimi i xhamave ne shkollat dhe Institucionet tjera komunal	/	/	35,000.00	M2 M' Copë	5,355 1,190 420	35,000.00
Furnizimi me artikuj ushqimor për kuzhinen Qendrore	/	/	400,000.00	Kg. Copë	8,423.5 4,500	74,000.00
Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore	/	/	250,000.00	/	299	250,000.00

Tabela 10: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Prishtinës.³⁷

Në tabelën numër 10, pasqyrohet fakti se Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të bëjë një planifikim të arsyeshëm për aktivitetet për furnizim, ashtu siç kërkohet me Ligjin e Prokurimit Publik.³⁸ Komuna nuk ka planifikuar njësi dhe sasi fare në Plan të prokurimit, ndërsa në fazat tenderuese vërehet se kemi njësi dhe sasi të caktuara për kontratat e monitoruara. Gjithashtu, tek aktivitetet “Furnizimi me pajisje teknologjike për nevojat e Komunës së Prishtinës”, në Plan të prokurimit është evidentuar si “Furnizim me paisje te IT per nevojat e Komunes” me vlerë të parashikuar 11,400.00€, ndërsa aktiviteti “Furnizimi me artikuj ushqimor për kuzhinen Qendrore”, është evidentuar si “Furnizim me artikuj ushqim per kuzhinen qenderore te çerdheve “ me vlerë 74,000.00€. Tek këto dy aktivitete vërehet që është planifikuar disa herë më shumë sesa vlera e parashikuar gjatë inicimit të aktiviteteve. Sa i përket mungesës së sasive dhe njërive të cilat nuk janë të vendosura fare në Plan të prokurimit, IKD dhe INPO kanë parashtruar pyetje në drejtim të Zyrës së Prokurimit të Komunës së Prishtinës, mirëpo nuk kemi pasë ndonjë përgjigje konkrete.

9.8. Komuna e Rahovecit

Një shumë mjaft e madhe e mjeteve buxhetore që ka në dispozicion Komuna e Rahovecit do të shkojnë për aktivitete të furnizimeve që ka planifikuar për vitin 2020. Në fakt, Komuna ka planifikuar të shpenzojë gjithsej 239,323.50€ për dhjetë aktivitete të furnizimeve. Pesë aktivitetet e para për vitin 2020 që ka iniciuar kanë vlerë të parashikuar 93,781.50€. Të dhënat lidhur me respektimin e Planit të prokurimit i gjeni në tabelën më poshtë.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Rahovecit						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €

³⁷ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Prishtinës <https://prishtinaonline.com/uploads/rptplanskidokument.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

³⁸ Neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1 , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

Furnizim me paisje mjekësore për fizioterapi për nevoja të QKMF – së	Komplet	1,00	10,650.00	/	28	10,650.00
Furnizim me paisje mjekësore për laborator për nevoja të QKMF – së	Komplet	1,00	20,350.00	/	1	20,350.00
Furnizim me gypa nga PVC	Komplet	1,00	46,755.00	m' Copë	7,160 70	44,135.00
Furnizim me rekuizita për nevojat e komunës së Rahovecit	Komplet	1,00	25,435.50	m2 Copë	222 5,325	10,476.50
Furnizim me flamuj, shtiza, kurora dhe buqeta lulesh për aktivitetet përkujtimore	/	/	/	Copë	1,790	8,170.00

Tabela I I: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Rahovecit.³⁹

Të dhënat në tabelë, tregojnë se Komuna e Rahovecit nga pesë aktivitetet e monitoruara, njërin nuk e ka fare të përfshirë në Plan të prokurimit, pra, bëhet fjalë për aktivitetin “Furnizim me flamuj, shtiza, kurora dhe buqeta lulesh për aktivitetet përkujtimore” me vlerë 8,170.00€.

Gjithashtu, vërehet se në Plan të prokurimit tek pjesa ku është dashur të vendoset njësia është përdorur shablloni “komplet” vetëm sa për të mbushur kolonën dhe gjithashtu njësinë matëse “1,00”. Me përjashtim të aktivitetit “Furnizim me paisje mjekësore për laborator për nevoja të QKMF -së”, të gjitha aktivitetet tjera të monitoruara nuk përputhen me fazën tenderuese.

Në dy aktivitete gjatë fazës tenderuese ka pasur vlerë të ndryshme të parashikuar; në fakt procedurat tenderuese janë filluar me vlerë më të ulët se sa është planifikuar me Plan. Të gjitha këto që u thanë më lartë janë tregues që Komuna e Rahovecit ka dobësi në planifikim të prokurimit.⁴⁰ Gjithashtu, tek aktivitetet “Furnizim me paisje mjekësore për fizioterapi për nevoja të QKMF – së” dhe “Furnizim me paisje mjekësore për laborator për nevoja të QKMF – së”, në fazën tenderuese tek lista e çmimeve mungojnë njësitë, në fakt janë përshkruar artikujt dhe sasia, po ashtu furnizimet fare nuk kanë të bëjnë me “komplet” ashtu siç figuron në Plan të prokurimit.

³⁹ Burimi: Plani i prokurimit i Komunës së Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/03/Planifikimi-Perfundimtare-i-Prokurimit-per-vitin-2020.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet.

⁴⁰ Shih gjithashtu, neni 8, paragrafi I, nënparagrafi I.1 , Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

Lidhur me ndryshimin e vlerave të parashikuara, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit z. Astrit Mullabazi është mbështetur në atë se këto vlera ndryshojnë për faktin se kur të hartohen projektet paraqitet projekti si i plotë, ndërsa gjatë planifikimit vetëm merren vlerat e përafërta nga KAB.

Lidhur me mospërfshirjen në Plan të prokurimit të aktivitetit “Furnizim me flamuj, shtiza, kurora dhe buqeta lulesh për aktivitetet përkujtimore,” z. Mullabazi ka sqaruar që ky aktivitet hyn në kuadër të aktivitetit të planifikuar me titull “Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit” ku pastaj gjatë fazave tenderuese ky aktivitet është ndarë në “Furnizim me flamuj, shtiza, kurora dhe buqeta lulesh për aktivitetet përkujtimore” dhe “Furnizim me rekuizita që janë pajisje sportive” për shkak se janë gjëra të ndryshme dhe këto furnizime i ofrojnë operatorë të ndryshëm.

9.9. Komuna e Vushtrrisë

Sikurse në të gjitha komunat edhe në Komunën e Vushtrrisë janë monitoruar pesë aktivitetet e para që janë iniciuar gjatë vitit 2020, e gjitha kjo për të parë se sa është respektuar Plani i prokurimit. Për furnizime, Komuna e Vushtrrisë ka planifikuar që t'i shpenzojë gjithsej 830,180.90€. Sa i përket respektimit të Planit të prokurimit, të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Vushtrrisë						
Emri kontratës	Planifikim			Tenderim		
	Njësia	Sasia	Vlera €	Njësia	Sasia	Vlera €
Furnizimi me makina për shpërndarjen e plehut organik	/	/	36,000.00	Copë	7	36,000.00
Furnizimi dhe montimi i serave me sipërfaqe 50m2	/	/	80,000.00	Copë Metër m2	2,900 12,760 8,700	108,996.50
Furnizimi me perde për objektet shkollore	/	/	5,900.00	m2	584,62	5,909.80
Furnizimi me pako higjienike dhe ushqimore për ndihmë të familjeve në nevojë	/	/	/	Pako	1,000	45,000.00
Furnizim me pemë dhe perime	/	/	/	Kg.	5,650	5,140.50

Tabela 12: Zbatueshmëria e Planit të prokurimit 2020, te aktivitetet për furnizim, Komuna e Vushtrrisë⁴¹

Ashtu siç shihet në tabelë, Komuna e Vushtrrisë nga pesë aktivitete të testuara, dy prej tyre i ka zhvilluar jashtë planifikimit, respektivisht të njëjtat nuk mund të identifikohen në Plan të prokurimit. Bëhet fjalë për projektin “Furnizimi me pako higjienike dhe ushqimore për ndihmë të familjeve në nevojë” dhe “Furnizim me pemë dhe perime”, të cilët vlerën totale e kanë 50,140.50€. Pra, Komuna e Vushtrrisë mbi 50,000.00€ euro do t'i shpenzojë pa i planifikuar fare paraprakisht.

Nga tri aktivitetet që ka iniciuar Komuna dhe që janë në planifikim të prokurimit, aktiviteti “Furnizimi dhe montimi i serave me sipërfaqe 50m²”, nuk ka vlerë të njëjtë e as të përafërt me Planin e prokurimit, përkatësisht Komuna ka planifikuar se ky aktivitet do të kushtojë 80,000.00€, ndërsa procedurat janë hapur me vlerë të parashikuar 108,996.50€. Gjithashtu, vërejmë se Komuna nuk ka vendosur fare sasi dhe njësi në Plan të prokurimit, ndërsa në fazat tenderuese vërejmë që kemi njësi dhe sasi të ndryshme gjë që nuk janë të paraqitura në Plan të prokurimit.

Të gjitha këto të gjetura dëshmojnë se Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur që të hartojë një planifikim konform nevojave reale dhe kërkesave ligjore.⁴² Në intervistën e zhvilluar me Drejtorin e Drejtorisë së Prokurimit z. Amir Haradinaj sa i përket ndryshimit të vlerave të parashikuara në Plan dhe gjatë inicimit, përgjigja është se në këto raste është e mundur që njësi kërkuese në momentin që vendosë vlerën e parashikuar nuk bënë vlerësimin real të nevojave, lidhur me mos vendosjen e sasive dhe njësi zyrtari në fjalë thotë se nuk ekziston ndonjë arsye e veçantë vetëm se kështu është shablloni dhe i vendosim vetëm ato vlera që janë. Sa i përket asaj që aktivitetet “Furnizimi me pako higjienike dhe ushqimore për ndihmë të familjeve në nevojë” arsyeja është se kjo ka ndodhur për shkak të rrethanave të paparashikuara lidhur me pandeminë Covid-19, kurse aktiviteti “Furnizim me pemë dhe perime” ka ndodhur si pasojë që AQP ka pasur probleme lidhur me procedurat e prokurimit dhe, sipas z. Haradinaj, Komuna është detyruar që të zhvillojë procedurë vetë në mënyrë që mos me i lanë keq fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

10. Numri i aktiviteteve të planifikuara për punë sipas planit të prokurimit dhe buxheti

Komunat, shumicën e buxhetit që kanë në dispozicion e shpenzojnë në investime kapitale, përkatësisht në projekte për punë. IKD dhe INPO, kanë analizuar koston buxhetore të aktiviteteve për punë që kanë planifikuar komunat për vitin 2020 dhe nëse kjo kosto është e njëjtë me kapacitetet buxhetore të komunës, respektivisht nëse plani i prokurimit është i bazuar në buxhet. Planin e prokurimit mund të mbetet vetëm një dëshirë në letër nëse komuna nuk ka mbulueshmëri buxhetore për aktivitetet e planifikuara.

Aktivitetet e planifikuara që parashihen në buxhet janë parashikime që mund të realizohen dhe zbatohen në praktikë sepse në instancë të fundit fatin e projektit e përcakton vlera e

⁴¹ Burimi: Planin e prokurimit të Komunës së Vushtrrisë <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2020/09/Rishikimi-i-planifikimit-t%C3%AB-planit-t%C3%AB-Prokurimit-1.pdf> dhe lista e çmimeve në e-prokurim për secilin aktivitet

⁴² Neni 8, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>

parashikuar, përkatësisht buxheti që ndahet për të. Në tabelën më poshtë janë renditur komunit sipas planifikimit të aktiviteteve për punë për vitin 2020.

Numri i aktiviteteve të planifikuara për punë sipas planit të prokurimit dhe buxhetit 2020					
Komuna	Numri i kontratave në plan	Vlera e parashikuar në plan (€)	Vlera në buxhetin 2020⁴³ (€)	Diferenca⁴⁴ (€)	Përqindja⁴⁵ (%)
Vushtrri	14	725,985.30	985,000	259,014.70	35%
Pejë	74	5,042,536.90	4,907,941	-134,595.90	-3%
Hani Elezit	28	591,772	569,772	-22,000	-4%
Rahovec	26	1,040,000	970,000	-70,000	-7%
Prishtinë	88	26,414,538.71	23,430,000	2,984,538.71	-12%
Gjakovë	53	6,970,082	4,018,000	-2,952.082	-43%
Gjilan	16	4,947,998.18	2,640,000	-2,307,998.18	-47%
Deçan	10	970,000	409,500	-560,500	-58%
Junik	12	575,467	76,000	-499,460	-87%
Gjithsej	321	47,278,380.09	38,006,213.00	-9,272,167.09	-20%

Tabela 13: Numri i kontratave të planifikuara për punë sipas planit të prokurimit dhe buxhetit 2020.⁴⁶

Të dhënat në tabelë dëshmojnë se asnjëra nga komunit nuk ka hartuar planin e prokurimit për aktivitetet për punë në bazë të kapaciteteve buxhetore që kanë në dispozicion për vitin 2020, përkatësisht, përjashtuar Komunën e Vushtrrisë, të gjitha komunit tjera kanë planifikuar aktivitete për punë të cilat tejkalojnë buxhetin e ndarë për zhvillimin e atyre projekteve për vitin 2020.

Në tabelë vërehet se ka raste kur komunit kanë planifikuar gati dyfish më shumë sesa që kanë buxhet për projektet e caktuara, si: Komuna e Gjakovës, Gjilanit dhe Deçanit, ndërsa Komuna e Junikut ka një dallueshmëri të madhe ku vlera e aktiviteteve për punë të planifikuara për vitin 2020 është 575,467.00€, ndërsa mundësitë buxhetore të komunës për këto aktivitete janë 76,000.00€, pra, kosto e projekteve të planifikuara është 499,460.00€ me e lartë sesa buxheti

⁴³ Sqarim: Kjo vlerë është totali i projekteve të planifikuara dhe që janë identifikuar në buxhet.

⁴⁴ Diferenca do të thotë se sa është dallimi në euro në mes të shumës totale që kanë aktivitetet e planifikuara për punë dhe sa është buxheti i komunës për vitin 2020 i ndarë për projektet në fjalë, pra, secilit projekt të planifikuar dhe që është identifikuar në buxhet i është marr vlera në buxhet për vitin 2020. Në rastet kur buxheti në total është më i madh se sa vlera e aktiviteteve të planifikuara atëherë shënon vlera e dallimit, ndërsa kur buxheti është më i vogël se sa planifikimi vlera është e shënuar me shenjën minus (-).

⁴⁵ Përqindja e ka kuptimin e asaj që vlera e përqindjes nëse është plus do të thotë se komuna ka buxhet më shumë se sa është planifikuar për atë qënd, ndërsa kur është minus do të thotë se planifikimi është atë qënd më i lartë se sa buxheti që komuna ka në dispozicion.

⁴⁶ Burimi: Planet e prokurimit të komunave dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

i disponueshëm për ato projekte. Për dallim nga komunat e tjera, Komuna e Vushtrrisë rezulton se vlerën totale të aktiviteteve të planifikuara për punë e ka më të ulët sesa buxhetin që ka në dispozicion për implementimin e aktiviteteve në fjalë. Kjo dhe dallimet e komunave të tjera janë tregues se komunat nuk marrin parasysh të gjitha faktorët kur hartojnë planin e prokurimit për vitin e ardhshëm dhe përfundimi është se kemi një planifikim i cili nuk paraqet gjendjen reale.⁴⁷

Duke e parë këtë dallueshmëri në mes të planifikimit të aktiviteteve për punë dhe kapacitetit buxhetor që kanë komunat për implementimin e tyre, është analizuar edhe ajo se planifikimet e komunave a kanë të bëjnë me projekte dy e më shumë vjeçare. Gjatë analizimit të planeve të prokurimit vërejmë se përveç Komunës së Gjilanit që ka një aktivitet tre vjeçar, komunat tjera nuk kanë aktivitete të tilla të cilat mund të identifikohen në plan të prokurimit. Aktiviteti tre vjeçar i komunës së Gjilanit është “Hapja e trasave rrugore-Projekt 3 vjeçar” me vlerë të planifikuar 130,000.00€, ndërsa për vitin 2020 në buxhet për këtë aktivitet janë të ndara 70,000.00€.

Në përgjithësi për vitin 2020, nëntë komunat kanë planifikuar t’i zhvillojnë gjithsej 321 aktivitete për punë me vlerë totale 47,278,380.09€, ndërsa vlera totale e buxhetit për implementimin e këtyre aktiviteteve që këto komuna kanë në dispozicion për vitin 2020 është 38,006,213.00€. Pra, në total kosto e aktiviteteve që kanë planifikuar komunat është 9,272,167.09€ më e lartë se sa kapaciteti real buxhetor që kanë në dispozicion për vitin 2020.

II. Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020

Realizimi i projekteve të planifikuara mund të jetësohet vetëm nëse komuna ka buxhet të disponueshëm për zhvillimin e projekteve dhe nëse projektet në fjalë i planifikon edhe në buxhet, në të kundërtën është e pamundur që të kemi realizim nëse komuna nuk ka buxhet. Plani i prokurimit është e domosdoshme që të mbështetet në buxhetin e komunës, përkatësisht duhet të jetë brenda parametrave të kapacitetit buxhetor dhe një planifikim i cili nuk e ka për bazë mundësinë buxhetore nuk mund të realizohet në praktikë. IKD dhe INPO kanë analizuar aktivitetet për punë që kanë planifikuar komunat dhe buxhetin e vitit 2020, për të mësuar se a mund të identifikohen të gjitha projektet e planifikuara në buxhet.

II.1. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit për vitin 2020 ka planifikuar që t’i zhvillojë gjithsej 10 aktivitete për punë me vlerë 970,000.00€. Nga 10 aktivitete 3 prej tyre nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020.⁴⁸ Të dhënat i gjeni të bashkangjitura në tabelën 14.

⁴⁷ Shih neni 8 i Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>, lidhur me nenin 5.4 i RrOUPP <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhezusi%2010%2004%202019%202.pdf>

⁴⁸ Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera € ⁴⁹
Renovimi i shkollave në Deçan	50,000.00
Rrenimi i Objekteve ndërtimore	50,000.00
Sigurimi i Objekteve Publike	60,000.00

Tabela 14: Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Deçanit⁵⁰

Vlera totale e aktiviteteve që nuk mund të identifikohen në buxhet është 160,000.00€. Mos identifikimin e këtyre projekteve në buxhetin 2020, Zyra e Prokurimit e Komunës së Deçanit e arsyeton me faktin e mungesave në buxhet dhe për arsyt tjera që mund t'i kenë njësitë e kërkesës.

11.2. Komuna e Gjakovës

Pjesën më të madhe të buxhetit të planifikuar për vitin 2020, Komuna e Gjakovës do ta përdorë për zhvillimin e aktiviteteve për punë, përkatësisht për këtë qëllim ka planifikuar gjithsej 6,970,082.00€. Nga 53 aktivitete të planifikuara për punë, nuk janë të identifikueshëm në buxhet 4 aktivitete. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Rrenimi i objekteve pa leje	30,000.00
Instalime dhe renovime të ngrohjes qendrore në shkolla	100,000.00
Riparimi i kalldajave dhe sistemit të ngrohjes qendrore	10,000.00

Tabela 15 : Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Gjakovës⁵¹

Lidhur me këto gjetje, Zyra e Prokurimit ka deklaruar që bëhet fjalë për projekte të cilat janë të financuara nga të hyrat vetjake andaj si të tilla nuk figurojnë në buxhetin qendror, mirëpo kjo është e pasaktë pasi që në Buxhetin e Republikës së Kosovës pasqyrohet buxheti i përgjithshëm që ka në dispozicion komuna, së bashku me të hyrat vetjake dhe të gjitha grantet që vijnë nga niveli qendror. Si rrjedhojë, këto projekte do të duhej të evidentoheshin në buxhetin e vitit 2020.

⁴⁹ Sqarim: Vlera e këtyre projekteve në tabelë janë vlera të parashikuar në plan të prokurimit, vlen për nëntë komunat lidhur me projektet që nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020.

⁵⁰ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

⁵¹ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

11.3. Komuna e Gjilanit

Sikurse të gjitha komunat, ashtu edhe Komuna e Gjilanit pjesën më të madhe të buxhetit e shpenzon për investime kapitale, respektivisht aktivitete për punë. Kostoja totale e planifikuar për aktivitete për punë është 5,064,157.00€, nga 16 aktivitete për punë në buxhet nuk mund të identifikohen 9 prej tyre. Këto të dhëna i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Punë Publike-projekte të vogla në infrastrukturë	570,000.00
Intervenimi me masa inovative të Eficiencës së Energjisë në shkollën Vesel Muja në fshatin Mihir	45,865.50
Ndërtimi i aneksit në shkollën Thimi Mitko	40,000.00
Ndërtimi i zyrës së gjendjes civile në lagjen Arbëria-Gjilan	30,000.00
Rregullimi i i varrezave të reja-rrethoja dhe pjesët e tjera përcjellëse infrastrukturore	240,000.00
Rregullimi i pjesës finale te kodra e dëshmorëve	480,000.29
Rregullimi i parkut Banja	347,132.39
Rregullimi i parkut të Pajtimit	365,000.00
Objekti i Administratës Publike	1,900,000.00

Tabela 16 : Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Gjilanit⁵²

Vlera totale e aktiviteteve të cilat nuk mund të identifikohen në buxhet është 4,017,998.18€. Lidhur me këto gjetje, është pyetur Menaxheri i Prokurimit z. Izet Kurteshi, i njëjti është sqaruar duke na dërguar disa kode buxhetore ku mund të identifikohen këto projekte në buxhet. Në këto kode ekzistojnë vlera buxhetore të cilat fare nuk përputhen me vlerat e parashikuara të këtyre aktiviteteve dhe emërtimin e tyre, pra, janë kode të përgjithshme. Edhe pas sqarimeve në buxhetin e vitit 2020 të Komunës së Gjilanit nuk mund të identifikohet aktiviteti “Objekti i Administratës Publike”, për të cilin aktivitet z. Kurteshi ka sqaruar se këtë aktivitet do ta financojë Ministria e Pushtetit Lokal.

11.4. Komuna e Hani Elezit

Komuna e Hanit të Elezit për vitin 2020 ka planifikuar t'i zhvillojë gjithsej 28 aktivitete për punë me vlerë totale 591,772.00€. Në buxhet nuk është identifikuar vetëm aktiviteti “Mirembajtja dhe riparimi i ndërtesave”.

⁵² Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Mirembajtja dhe riparimi i ndërtesave	22,000.00

Tabela 17 : Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Hanit të Elezit⁵³

11.5. Komuna e Junikut

Komuna e Junikut buxhetin për investime kapitale, përkatësisht për aktivitete për punë për vitin 2020 e ka 159,305.00€, ndërsa për 17 aktivitete që ka planifikuar t'i zhvillojë e kapin vlerën 575,467.00€. Aktivitetet që i ka planifikuar Komuna e që IKD dhe INPO nuk kanë mundur t'i identifikojnë në buxhetin 2020 i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Ndërtimi i parqeve dhe këndeve të lojërave për fëmijë	100,000.00
Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Gjocaj dhe Jasiq	150,000.00
Renovimi i objektit të komunës	20,000.00
Mbuloja për generator dhe kontejnerë të mbeturinave	3,000.00
Ndërtimi i shtëpisë alpine bjeshkatore faza III	50,000.00
Riparimi i kanalizimit të ujit repartit i stomatologjisë	2,000.00
Identifikimi dhe hapja e shtigjeve për ecje	22,500.00

Tabela 18: Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Junikut.⁵⁴

Vlera totale e aktiviteteve që komuna e Junikut nuk i ka të mbështetura në buxhetin 2020 është 347,500.00€. Zyra e Prokurimit është pyetur për këtë çështje dhe përgjigja ka qenë se “Dallimi është si rezultat i gjitha kërkesave drejtuar Zyrës së Prokurimit nga departamentet kërkuese për iniciimin e këtyre aktiviteteve të prokurimit”.

11.6. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës është ndër komunat që ka planifikuar një buxhet të konsiderueshëm për aktivitete për punë, përkatësisht për 74 aktivitete planifikon t'i shpenzojë 5,042,536.90€. Në analizën se aktivitetet e planifikuara a kanë mbështetje në buxhetin e Komunës së Pejës,

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

rezulton që dy aktivitete të planifikuara nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020. Këto të dhëna i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Toaletet ne Drejtoratin e Arsimit	15,000.00
Regullimi i Varezave te martireve pjesa e dyt	5,000.00€

Tabela 19: Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Pejës⁵⁵

Të dhënat në tabelë vërtetojnë se nga 74 aktivitete për punë që ka planifikuar Komuna e Pejës, 2 prej tyre nuk mund të identifikohen në buxhet, vlera e aktiviteteve që nuk mund të identifikohen në buxhet është 20,000.00€. IKD dhe INPO, fillimisht nuk kanë mundur t'i identifikojnë 37 aktivitete për punë, mirëpo pas bisedës me Udhëheqësin e Prokurimit z. Xhemë Berisha, i njëjti ka shpjeguar që bëhet fjalë për ndryshime në emërtime të aktiviteteve dhe, përjashtuar dy projektet e paraqitura në tabelën numër 19, për secilin projekt të pidentifikuar kemi pranuar instruksione se ku mund të gjenden në buxhet, madje disa nga këto aktivitete do të financohen me pjesëmarrje në projektin DEMOS. Pra, bëhet fjalë për tituj të ndryshëm dhe për kode buxhetore të përgjithshme të cilat pamundësojnë që të identifikohen këto aktivitete.

11.7. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka buxhetin më të madh në kuadër të komunave të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë edhe për aktivitete për punë ka të planifikuar buxhet dukshëm më të madh se sa komunat tjera, respektivisht për vitin 2020 ka planifikuar që për 88 aktivitete për punë t'i shpenzojë gjithsej 26,414,538.71€. Në tabelën më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me aktivitete të planifikuara për të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin për vitin 2020.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Ndërtimi i parkut tek 'Rruga B'	300,000.00
Ndërtimi i parkut në Prugoc	220,000.00
Ndërtimi i parkut të qenve në Taslixhe	80,000.00
Inventarizimi i hapësirave publike	280,000.00
Ndërtimi I QMF - Prishtina e Re Zona Perendim	400,000.00

Tabela 20: Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Prishtinës⁵⁶

⁵⁵ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

⁵⁶ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

Nga 88 aktivitete të planifikuara, mbulueshmëri në buxhet Komuna e Prishtinës nuk ka për pesë aktivitete me vlerë totale 1,280,000.00€. Problematikë në Komunën e Prishtinës është ajo se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve për punë janë të vendosura në dy kode buxhetore dhe si të tilla ka qenë e vështirë të identifikohen se sa mjete janë ndarë për secilin projekt. Pas sqarimeve nga Zyra e Prokurimit, të pa identifikuar në buxhet mbesin projektet e cekura në tabelën numër 20. Gjithashtu, Menaxheri i Prokurimit z. Zekë Bardhaj ka potencuar se në mesin e 88 projekteve për punë të planifikuar për vitin 2020, janë edhe katër projekte të bartura nga viti 2019; bëhet fjalë për projektet: “Rigjenerimi i rrugës Mehmet Kaçurri (Rruga Model) – Prishtinë”, “Ndertimi I rruges nga Flotacioni, lagja Vakocv”, “Rregullimi I varrezave te deshmoreve ne Viti te Marecit”, “Rregullimi I rrugeve dhe infrastruktures ne rruget te trafoja”. Vlera totale e këtyre projekteve është 1,444,038.71€.

11.8. Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit për vitin 2020 ka planifikuar që për 26 aktivitete për punë t’i shpenzojë gjithsej 1,040,000.00€. Aktivitetet për punë që nuk mund të identifikohen në buxhet i gjeni të bashkangjitura në tabelë.

Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020	
Emri i kontratës	Vlera €
Rrenimi i objekteve pa leje	20,000.00€
Sinjalizimi vertical dhe horizontal i rrugëve	30,000.00€
Përkrahja e bizneseve	20,000.00€

Tabela 21: Aktivitetet për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020, Komuna e Rahovecit⁵⁷

Vlera totale e aktiviteteve për punë të cilat nuk mund të identifikohen në buxhet është 70,000.00€. Lidhur me këto gjetje, Zyra e Prokurimit është sqaruar se bëhet fjalë që këto mjete janë ridestinuuar për projekte të tjera dhe se ky ridestinim bëhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga analizimi dhe krahasimi i buxhetit fillestar dhe plotësim-ndryshimet e tij, nuk mund të përfundojmë në një konstatim i tillë, sepse në buxhetin fillestar komuna ka pasur 3,905,770.00€, ndërsa në plotësimin e tij 3,921,730.00€, përkatësisht 15,960.00€ më shumë.⁵⁸

11.9. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë do të shpenzojë më së paku buxhet për aktivitete për punë, në krahasim me shpenzimet e planifikuara për shërbime dhe furnizime, përkatësisht shpenzimet e

⁵⁷ Burimi: Plani i prokurimit dhe Ligji Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>

⁵⁸ Për më shumë shih Ligji nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, i datës 19 Mars (<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>) dhe Ligji nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, datë 7 Gusht (<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9D16BECD-DDF8-4144-BCBB-4CE9945F5CDD.pdf>).

planifikuara për aktivitetet për punë janë 725,985.30€. Nga 14 aktivitete për punë që komuna ka planifikuar t'i zhvillojë, të gjitha janë të bazuara në buxhet, pra, planifikimin e prokurimit tek aktivitetet për punë e ka të bazuara në buxhet.⁵⁹ Komuna e Vushtrrisë është shembull se si planifikimi i prokurimit duhet të jetë i bazuar në kapacitetet buxhetore të komunës.

12. Përputhshmëria e aktiviteteve afatgjate për punë 1-3 vjet me Kornizën Afatmesme Buxhetore të komunave

Korniza Afatmesme Buxhetore (tutje: KAB) është një dokument shumë i rëndësishëm i cili derivon nga Ligji Nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe qarkoret buxhetore që lëshon Ministria e Financave çdo vit. Pra, KAB është një obligim që buron nga qarkorja dhe në esencë është një dokument i cili miratohet çdo vit nga kuvendet komunale. Rëndësia e tij qëndron aty se i njëjti siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve komunale dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal.⁶⁰

Rëndësia e KAB-it qëndron gjithashtu edhe në atë se ky dokument siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave dhe prioritetëve të komunave, duke mundësuar kështu integrimin e tyre në procesin buxhetor. KAB përveç që është një obligim ligjor, është edhe një pasqyrë e cila paraqet prioritetet e komunës për shpërndarjen e buxhetit për një periudhë tri vjeçare.

Në vazhdim IKD dhe INPO kanë monitoruar pesë aktivitetet e para për punë me kohëzgjatje 1 deri 3 vjet, që kanë iniciuar komunat gjatë vitit 2020, respektivisht ka analizuar përputhshmërinë e tyre me KAB-in 2020-2022 e komunës. Pra, a respektohet KAB nga ana e komunave, përkatësisht parashikimet buxhetore të pasqyruara në këtë dokument a mbesin të pandryshuara edhe kur fillojnë procedurat tenderuese. Gjithashtu, këtu do t'i jepet përgjigje edhe asaj se pesë projektet e para për punë me kohëzgjatje 1 deri 3 vjet që kanë iniciuar komunat, a janë të gjitha të identifikueshme në KAB si një dokument i hollësishëm i të hyrave dhe shpenzimeve të komunës.

12.1. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit deri më 19.11.2020 ka iniciuar vetëm tri aktivitete për punë me kohëzgjatje 1-3 vite, me vlerë totale 544,700.00€. Nga analizimi i KAB-it të Komunës së Deçanit dhe aktiviteteve në fjalë, rezulton që asnjëri nga këto aktivitete për punë nuk figuron në KAB. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

⁵⁹ Për më shumë, shih, po aty.

⁶⁰ Shih, neni 20, paragraf 2, i Ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, lidhur me nenin 5 të Ligjit 05/L -063, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-048 (2016) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524> / <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Deçanit		
Emri dhe numri i kontratës	Vlera totale në KAB ⁶¹	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Programi për Energji Efiçiente në Komunën e Deçanit	/	390,000.00€
Ndertimi i Ambulantës së Mjekësisë Familjare – Gramaqel	/	67,200.00€
Ndërtimi i shtratit të lumit në Irzniq në Lagjën Berisha, Mushkolaj dhe Dodaj-Deçan”	/	87,500.00€

Tabela 22: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Deçanit⁶²

Lidhur me këto gjetje, Zyra e Prokurimit e Komunës së Deçanit, përkatësisht zyrtari përgjegjës z. Xhevdet Ramosaj, është përgjigjur se: Aktiviteti “Programi për Energji Efiçiente në Komunën e Deçanit” është aktivitet i financuar me marrëveshjen e mirëkuptimit me Agjencinë e Kosovës për Efiçencë dhe Energji, aktiviteti “Ndërtimi i shtratit të lumit në Irzniq në Lagjën Berisha, Mushkolaj dhe Dodaj-Deçan” është i financuar me marrëveshjen e mirëkuptimit me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit dhe se për këtë nuk kanë mundur të parashihen në KAB. Sa i përket aktivitetit “Ndertimi i Ambulantës së Mjekësisë Familjare – Gramaqel” për shkaqe të pandemisë dhe nevojës emergjente për intervenime në shëndetësi ka ardhur si kërkesë nga Drejtoria për Shëndetësi, dhe për këtë nuk figuron në KAB.

12.2. Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka inicuar aktivitete për punë 1-3 vjet dhe pesë aktivitetet e para për këtë vit kapin koston totale të parashikuar 710,455.12€. Këto të dhëna dhe krahasimet me KAB i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Gjakovës		
Emri dhe numri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Korenicë	130,000.00€	129,999.97€
Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ramoc	140,000.00€	169,931.98€

⁶¹ Sqarim për të gjitha komunat: Kolona vlerat totale në KAB është vendosur në atë mënyrë që nëse vlera e aktivitetit të inicuar përputhet ose është e përafërt vetëm me vlerën e paraparë për vitin 2020 në KAB, atëherë është vendosur jo vlera totale për 3 vite por vetëm për atë vit, në rastet tjera është vendosur vlera totale për tri vite në KAB.

⁶² Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Deçanit 2020/2022 dhe platforma e-prokurim.

Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatin Pnish – Lagja Ramadan Hiseni	160,532.00€	160,531.77€
Ndërtimi dhe sanimi i urave	50,000.00€	49,991.40€
Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve	450,000.00€	200,000.00€

Tabela 23: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Gjakovës.⁶³

Pesë aktivitetet e para me kohëzgjatje 1-3 vite që ka inicuar Komuna e Gjakovës janë paraparë me KAB-in 2020-2022 të Komunës së Gjakovës. Të dhënat në tabelë pasqyrojnë se gjatë fazës tenderuese vlera e parashikuar është brenda parashikimeve në KAB, përkatësisht nuk është tejkaluar KAB. Përrjashtimisht aktiviteti “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ramoc” njoftimi për kontratë është 19,931.98€ më i lartë se sa vlera e parashikuar në KAB, ndërsa aktiviteti “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve” është inicuar me 200,000.00€, ndërsa në KAB për vitin 2020 dhe 2021, Komuna ka në dispozicion vetëm nga 100,000.00€, kurse për vitin 2022 ka 250,000.00€, në total 450,000.00€. Sa i përket këtyre gjetjeve, Zyra e Prokurimit e Komunës së Gjakovës, ka pasur sqarimin e njëjtë sikurse për projektet për punë që nuk mund të identifikohen në buxhetin 2020. Sipas tyre projektet që financohen nga të hyrat vetjake nuk mund të paraqiten në KAB, gjë që nuk është e saktë sepse KAB është një dokument i cili në mënyrë të hollësishme i paraqet të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e komunës për një periudhë prej tre vitesh.

12.3. Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit e ka të miratuar KAB-in 2020-2022, mirëpo në këtë dokument nuk mund të identifikohen aktivitetet për punë, përkatësisht nuk janë të paraqitura projektet për punë dhe financimi i tyre për tre vite ashtu siç planifikohet në KAB dhe si rrjedhojë pasqyrimi i respektimit të këtij dokumenti kaq të rëndësishëm ka qenë i pamundur.⁶⁴ IKD dhe INPO nëpërmjet platformës e-prokurimi kanë identifikuar katër aktivitete për punë me kohëzgjatje 1-3 vite që ka inicuar komuna gjatë vitit 2020, përkatësisht projektet: “Rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotualet, ndriçimi publik në Sos fshatin në Zabel”, “Implementimi i Parqeve Baja, Paqes, Pajtimit dhe Parku Kodra e Dëshmorëve”, “Punë Publike - projekte të vogla në infrastrukturë” dhe “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit tretë, pastrimi i lumenjëve dhe largimi i deponive të egra”. Mirëpo, meqë KAB i Komunës së Gjilanit nuk i përmban të dhënat e mjaftueshme lidhur për aktivitetet për punë dhe përkundër përpjekjeve që të sigurohet ndonjë dokument shtesë që pasqyron financimin e këtyre projekteve, ka qenë e pamundur që të bëhet një analizë e tillë.

⁶³ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Gjakovës 2020/2022 <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2018/02/Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-2020-2022.pdf> dhe platforma e-prokurim.

⁶⁴ KAB 2020-2022, Komuna e Gjilanit, <https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/kab/?page=2019>

12.4. Komuna e Hani Elezit

Komuna e Hanit të Elezit deri në këtë kohë ka zhvilluar vetëm dy projekte me kohëzgjatje 1-3 vite, vlera totale e këtyre projekteve është gjithsej 823,983.00€. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Hanit të Elezit		
Emri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera në njoftimin për kontratë
Ndertimi i Shtepise se Kultures Imri Curri - Hani i Elezit (faza e II)	160,000.00€	499 983.00€
Ndertimi i salles se sporteve ne SHFMU. Veli Ballazhi ne Gorance	160,000.00€	324 000.00€

Tabela 24: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Hanit të Elezit⁶⁵

Nga të dhënat në tabelë, vërejmë se të dy aktivitetet janë të parapara në KAB të komunës, mirëpo vlerat e parapara nuk janë aspak të përafërta. Në projektin “Ndertimi i Shtepise se Kultures Imri Curri - Hani i Elezit (faza e II), kostoja apo vlera e paraparë në KAB është 160,000.00€, ndërsa vlera e parashikuar në njoftimin për kontratë është 499,983.00€. Në aktivitetin tjetër “Ndertimi i salles se sporteve ne SHFMU. Veli Ballazhi ne Gorance” gjithashtu është tejkalar vlera e parashikuar nga 160,000.00€ sa ishte paraparë në KAB, njoftimi për kontratë është publikuar me vlerë 324,000.00€. Pra, në të dy projektet me kohëzgjatje 1-3 vjet nuk është respektuar KAB i komunës, për nga vlera e parashikuar e aktiviteteve, madje është tejkalar për disa fish. Lidhur me këto gjetje Menaxheri i Zyrës së Prokurimit z. Xhevdet Bushi ka shpjeguar se ky dallim ka ndodhur për faktin se fillimisht janë paraparë ato vlera, ndërsa gjatë detajizimit të projekteve është parë se kushtojnë më shumë dhe janë vendosur këto vlera, paratë janë siguruar nga rialokime dhe transfere nga projektet e tjera dhe gjithashtu ka pasur donacion edhe nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe DEMOS. Të gjitha këto flasin për dobësi gjatë hartimit të KAB-ti nga ana e Komunës së Hanit të Elezit.

12.5. Komuna e Junikut

Në Komunën e Junikut është identifikuar vetëm aktiviteti “Rehabilitimi i rrugëve lokale” i cili në KAB do të ketë financim total 70,000.00€, përkatësisht 30,000.00€ dhe nga 20,000.00€ për vitin 2021 dhe 2022. Të dhënat në tabelën më poshtë dëshmojnë se vlera me të cilën është inicuar aktiviteti është 10,000.00€ më e lartë se sa parashikimet që janë bërë në KAB-in e Komunës së Junikut.

⁶⁵ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit 2020/2022 <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/category/korniza-afatmesme-buxhetore-kab/?page=2019> dhe platforma e-prokurim.

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Junikut		
Emri dhe numri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Rehabilitimi i rrugëve lokale	70,000.00€	80,000.00€

Tabela 25: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Junikut⁶⁶

Lidhur me dallimin në mes të parashikimeve në KAB dhe gjatë inicimit të procedurës, Udhëheqësja e Prokurimit znj. Florinda Maloku, ka deklaruar se “Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB është një orientim i projekteve dhe vlera e llogaritur e projekteve në KAB është vlerë e përafërt e projekteve e cila mund ose të qëndrojë e tillë ose mund të ndryshojë pas aprovimit të buxhetit për atë vite fiskal.” Pra, ndryshimi prej 10,000.00€ është si pasojë e asaj se parashikimet në KAB janë thjeshtë një orientim dhe ato mund të ndryshojnë pas miratimit të buxhetit.

12.6. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës, pesë aktivitetet e para për punë me kohëzgjatje 1-3 vite i ka me vlerë totale të parashikuar 4,947,605.39€. Krahasimet në mes të KAB dhe aktiviteteve të iniciuara i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Pejës		
Emri dhe numri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Ndërtimi i rrugës “ Varri i Sykut – Kofile – Shtypeq i Madh” në Rugovë	2,400,000.00€	794,745.53€
Ndërtimi i rrugës “Drelaj – Leqinat “ në Rugovë	2,400,000.00€	792,901.26€
Ndërtimi i rrugës Magra - Gropa e Madhe - Shkrelë në Rugovë	2,400,000.00€	450,000.00€
Asfaltimi i rrugëve në Qytet dhe fshatra të Komunës së Pejës LOT 1 – Asfaltimi i rrugëve në fshatin Novosellë LOT 2 – Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Radavc , Dubov , Ozdirm LOT 3 - Asfaltimi i rrugëve në fshatin Vitomeric LOT 4 - Asfaltimi i rrugëve në Qytetin e Pejës LOT 5 - Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Turjakë, Rosujë	3,800,000.00€	2,487,569.50€

⁶⁶ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Junikut 2020/2022 <https://kk.rks-gov.net/junik/korniza-afatmesme-buxhetore-komunale-2020-2022-2/> dhe platforma e-prokurim.

Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë LOT 1 - Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë - punët e vrazhda LOT 2 - Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë - punët finale	100,000.00€	422,389.10€
--	-------------	-------------

Tabela 26: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Pejës⁶⁷

Nga tabela vërejmë se pesë aktivitetet e para për punë që ka iniciuar Komuna e Pejës mund të identifikohen në KAB 2020-2022. Sa i përket vlerave të parashikuara, vërejmë se në asnjërin rast nuk kemi as për së afërmi vlerë të njëjtë të parashikuar. Sa i përket tri aktivitetëve të para në KAB komuna i ka futur në një kod të vetëm “Ndërtimi i rrugëve në Rugovë” ku për tri vite janë paraparë 2,400,000.00€, ndërsa deri më tani janë hapur procedura në vlerë 2,037,646.79€.⁶⁸

Aktiviteti “Asfaltimi i rrugëve në Qytet dhe fshatra të Komunës së Pejës LOT 1 – Asfaltimi i rrugëve në fshatin Novosellë LOT 2 – Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Radavc , Dubov , Ozdirm LOT 3 - Asfaltimi i rrugëve në fshatin Vitomeric LOT 4 - Asfaltimi i rrugëve në Qytetin e Pejës LOT 5 - Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Turjakë, Rosujë”, në KAB është i ndarë në dy projekte “Ndertimi i Rrugeve ne Qytet” me vlerë totale për tri vite 1,000,000.00€ dhe “Ndertimi i rrugeve ne fshatra” me vlerë totale për tri vite 2,000,800.00€. Pra, në këtë aktivitet dhe në aktivitetin “Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë LOT 1 - Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë - punët e vrazhda LOT 2 - Ndërtimi i puntorive në SH.M.L.T “Shaban Spahija” ne Pejë - punët finale”, Komuna ka iniciuar aktivitete me vlerë të parashikuar shumë më të lartë sesa ajo e parashikuar në KAB.

Nga këto të dhëna, përfundojmë se Komuna e Pejës nuk ka arritur që ta zbatojë Kornizën Afatmesme Buxhetore të cilën e ka votuar Kuvendi Komunal gjatë vitit 2019. Lidhur me këto gjetje Menaxheri i Prokurimit z. Xhemë Berisha është sqaruar se gjatë kësaj kohe kanë ndryshuar rrethanat, janë rritur kërkesat e komunitetit dhe këtë gjë e ka vlerësuar njësia kërkuese si të mundshme dhe pastaj është aprovuar nga ZKA-ja.

12.7. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës pesë aktivitetet e para për punë me kohëzgjatje 1-3 vjet, që i ka inicuar në vitin 2020 i ka me vlerë të parashikuar 1,500,000.00€. Nga pesë aktivitetet e para, aktiviteti “Hapja e rrugeve te reja ne Komunen e prishtines” nuk mund të identifikohet në KAB. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Prishtinës		
Emri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Intervenimi dhe mirembajtja ne pompa, kanalizim atmosferik,	200,000.00€	200,000.00€

⁶⁷ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Pejës 2020/2022 <https://kk.rks-gov.net/peje/category/raportet-financiare/kab/?page=2019> dhe platforma e-prokurim

⁶⁸ Shih KAB 2020-2022 Komuna e Pejës <https://kk.rks-gov.net/peje/category/raportet-financiare/kab/?page=2019>

fontana, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese		
Shtirirja e sistemit te ujitjes ne parqet e qytetit	200,000.00€	200,000.00€
Grumbullimi ,transportimi dhe asgjesimi i mbetjeve mjekesore KPSH	180,000.00€	150,000.00€
Hapja e rrugeve te reja ne Komunen e prishtines	/	450,000.00€
Rikonstruimi dhe gëlqerosja e shkollave	550,000.00€	500,000.00€

Tabela 27: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Prishtinës.⁶⁹

Nga të dhënat në tabelë vërejmë se nga pesë aktivitetet e para për punë, një nga to nuk është e përfshirë fare në KAB, ndërsa për projektet tjera vërehet një respektim i KAB-it, përkatësisht në dy aktivitete vërehet vlerë identike, ndërsa në dy aktivitete tjera me KAB është planifikuar 30 mijë, respektivisht 50 mijë euro më shumë. Menaxheri Prokurimit z. Zekë Bardhaj lidhur me aktivitetin “Hapja e rrugeve te reja ne Komunen e prishtines” ka deklaruar që i njëjti nuk mund të identifikohet në KAB sepse është në kuadër të projektit “Ndërtimi i rrugëve në pjesën rurale me infrastrukture përcjellëse”.

12.8. Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit e ka votuar KAB-in 2020-2022, mirëpo njëjtë si në rastin e Komunës së Gjilanit nuk i përshkruan në mënyrë të detajuar shpenzimet për projektet kapitale për periudhën 3 vjeçare, mirëpo vetëm në shifra të përgjithshme paraqiten shpenzimet për këtë kategori.⁷⁰ Sidoqoftë, aktivitetet për punë 1-3 vjet që ka iniciuar Komuna e Rahovecit janë: “Rrënimi i objekteve pa leje si dhe konfiskimi i mallrave”, “Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejnë”, “Intervenimet emergjente në infrastrukturë në komunën e Rahovecit”, “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në komunën e Rahovecit”, dhe “Ndërtimi i QMF-së në Apterushë”. Vlera totale e parashikuar e këtyre aktiviteteve është 511,565.38€. Mirëpo, për arsyet e cekura më lart krahasimi me KAB ka qenë i pamundur.

12.9. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2020 ka të iniciuara aktivitete për punë me kohëzgjatje 1 deri 3 vjet, ndërsa pesë aktivitetet e para të këtij lloji kanë vlerë të parashikuar 3,506,275.56€. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

⁶⁹ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Prishtinës 2020/2022 dhe platforma e-prokurim. https://prishtinaonline.com/uploads/2_kab_2020-2022_1.pdf

⁷⁰ KAB 2020-2022, Komuna e Rahovecit <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/04/KAB-2020-2022.pdf>

Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Vushtrrisë		
Emri i kontratës	Vlera totale në KAB	Vlera totale në njoftimin për kontratë
Asfaltimi i rrugëve në lokale në fshatra sipas lot1 dhe lot 2	1,700,000.00€	2,399,482.80€
Ndërtimi i Kanalizimeve sipas LOT1 dhe LOT2	610,874.00€	637,944.47€
Rikonstruimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale me infrastruktur	490,000.00€	297,675.29€
Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik	90,000.00€	81,173.00€
Intervenimi në raste emergjente	/	90,000.00€

Tabela 28: Aktivitetet për punë afatgjata 1-3 vjet dhe KAB, Komuna e Vushtrrisë⁷¹

Nga tabela më lart vërejmë se nga pesë aktivitetet e monitoruara, njëri nga ta nuk figuron fare në KAB të Komunës së Vushtrrisë, përkatësisht aktiviteti “Intervenimi në raste emergjente” në vlerë 90,000.00€. Në dy aktivitetet e para vërejmë se kemi tejkalim të vlerës së parashikuar, respektivisht procedurat tenderuese kanë filluar me vlerë më të madhe të parashikuar sesa ajo që është parashikuar në KAB, ndërsa në dy aktivitetet tjera është e kundërta. Në përgjithësi vërehet se Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur të hartojë një KAB i cili paraqet shpenzimet reale për projekte kapitale, sepse vërejmë se dokumenti i tillë nuk është respektuar. Sa i përket aktivitetit “Intervenimi në raste emergjente” i cili nuk është paraparë fare në KAB, Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit z. Amir Haradinaj ka sqaruar se pas diskutimeve që ka pasur me Drejtorinë e Financave ky projekt është më shumë mallra dhe shërbime dhe për atë nuk është parapa në KAB 2020/2022. Sidoqoftë, ky aktivitet në platformën e-prokurimi është aktivitet për punë me kohëzgjatje 36 muaj.⁷²

13. Rëndësia e analizimit të tregut gjatë fazës së planifikimit të prokurimit

Planifikimi i prokurimit duhet të bëhet në përputhje me nevojat e autoriteteve kontraktuese dhe sigurisht edhe me mundësitë buxhetore që kanë komunitat. Në fakt, plani i prokurimit është një dokument përfundimtar, ndërsa përgatitja e tij kalon nëpër shumë njësi brenda autoriteteve kontraktuese kështu duke marrë në sasi të konsiderueshme kohë, mund dhe energji. Sigurisht që ajo çfarë u tha më lart varet shumë edhe nga serioziteti i autoritetit kontraktues, përkatësisht nga ajo se a është qëllimi që të hartohet një planifikim serioz dhe profesional, apo ideja është që vetëm të hartohet një dokument sa për të qenë aty.

⁷¹ Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Vushtrrisë 2020/2022 <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/wp-content/uploads/sites/33/2019/07/KAB-2020-2022-pdf.pdf> dhe platforma e-prokurim

⁷² Për më shumë shih publikimin në platformën e-prokurimi https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1150289

Indikator shumë i rëndësishëm për ta rritur cilësinë e planit të prokurimit është edhe analizimi i tregut, përkatësisht analizimi i tregut lidhur me furnizimet, shërbimet dhe punët që planifikon apo ka nevojë që autoriteti kontraktues t'i zhvillojë gjatë vitit të ardhshëm. Analizimi i tregut duhet të bëhet nga njësitë kërkuese, përkatësisht nga drejtoritë e ndryshme dhe analiza shtrihet varësisht nga fusha që planifikohet të prokurohet, pra furnizim, shërbim, apo punë.

Analizimi i tregut mund të bëhet në mënyra të ndryshme; një nga mënyrat e vlerësimit të tregut që është e lehtë dhe mjaftë e saktë është analizimi i prokurimeve parapake. Kjo nënkupton se njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit duhet t'i shikojë prokurimet e ngjashme që autoriteti ka bërë gjatë viteve të kaluara në mënyrë që edhe ta mësojë koston reale, por edhe të mësojë nga lëshimet eventuale në të kaluarën. Pra, duke shikuar dhe analizuar kostot e prokurimeve të mëhershme të cilat kanë qenë të ngjashme apo të njëjta, autoriteti kontraktues mund të përcaktojë një kosto reale për aktivitetin që planifikon ta realizojë gjatë vitit të ardhshëm fiskal.

Gjithashtu, njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit mund të analizojnë edhe kontrata të ngjashme që kanë zhvilluar autoritetet e tjera. Në fakt, mund të rastisë që autoriteti i caktuar të mos ketë prokuruar më herët një punë, shërbim apo furnizim të caktuar; në këto raste mund të shikohen prokurimet që kanë zbatuar autoritetet e tjera, ku pastaj mund të përcaktohet një vlerë e parashikuar lidhur me një aktivitet.

Mënyrë tjetër e analizimit të tregut është edhe dalja në terren. Dalja në terren është shumë e rëndësishme, sepse aty përveç njoftimit me vendin e kryerjes së punëve, shërbimeve apo furnizimeve të caktuara, aty merren parametra të ndryshëm që sigurisht janë të rëndësishëm gjatë caktimit të kostos së parashikuar; pra në rrethana normale, posaçërisht për kontratat për punë planifikimi i punëve pa dalje paraprake në terren është i papranueshëm. Dalja në terren duhet të bëhet me profesionistë të fushës, sepse varësisht nga natyra e prokurimit duhet të konkludohen çështje të caktuara të cilat janë të lidhura me përvojë dhe ekspertizë profesionale. Për shembull, nëse planifikohet ndërtimi i një ure, sigurisht se gjatë daljes në terren, përkatësisht në vendin ku do të kryhen punët, do të duhej të ishte një inxhinier apo arkitekt që zakonisht janë të punësuar në njësinë kërkuese. Pra, gjatë daljes në terren kalkulohen shumë çështje, ku secila prej tyre e ka një kosto e cila pastaj do të reflektojë edhe në vlerën totale të parashikuar të aktivitetit përkatës.

Gjithashtu, vlerësimi i tregut, përkatësisht vendosja e vlerave të parashikuara lidhur me paramasat e caktuara duhet të bazohet edhe në manualet për çmimet referente për njësi të nxjerrura nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.⁷³ Këto çmime referente ndihmojnë autoritetin e caktuar që koston e njërive të caktuara ta llogarisë në mënyrë reale, sepse në këto manuale gjenden çmimet e përafërta të tregut.

Një analizë e mirë e tregut ka dy efekte: së pari, procedurat e prokurimit zhvillohen në bazë të parashikimeve dhe se problemet e autoritetit kontraktues lidhur me zhvillimin e procedurave urgjente do të jenë minimale. Ndërsa, së dyti, me një planifikim të detajuar dhe duke bërë analizë profesionale të tregut mundësohet që vlera e parashikuar për aktivitetet e planifikuara të jetë reale, sepse posaçërisht kur vlera e parashikuar është më e madhe gjë që nuk ka qenë e rrallë gjatë monitorimit, pamundëson që qytetarët të marrin edhe një furnizim,

⁷³ Shih, faqja zyrtare KRPP, manualet për çmimet referente për njësi https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCICr&PPRCMenu_OpenNode=71

shërbim a punë tjetër, me paratë që do të siguroheshin nga një planifikim profesional. Pra, kur planifikimi është përtej kostos reale, ajo shumë e parave mbetet e bllokuar për atë aktivitet dhe nëse do të planifikohej mirë, me paratë e tepërta do të planifikohej një aktivitet tjetër për qytetarët.

14. Vlerësimi i tregut gjatë procesit të planifikimit

INPO dhe IKD kanë zhvilluar intervista me zyrtarët e prokurimit të komunave të monitoruara, ku një ndër pyetjet kryesore ka qenë ajo se si komunat e vlerësojnë tregun gjatë fazës së planifikimit të prokurimit. Përgjigjet kanë qenë të koncentruara kryesisht në dalje në terren dhe në prokurimet paraprake. Tek daljet në terren, zyrtarët në fjalë kanë sqaruar se njësia kërkuese del në terren dhe gjatë shikimit të vendit të ngjarjes e cakton edhe një kosto të përafërt të aktivitetit të caktuar, ndërsa tek prokurimet e mëhershme shikohen kontratat që janë dhënë për çështjen e ngjashme dhe nga to nxirret pastaj një vlerë e përafërt. Është e rëndësishme se asnjëra komunë nuk ka përdorur disa mënyra të vlerësimit të tregut së bashku por vetëm një nga to. Të bashkangjitur më poshtë gjeni tabelën me të dhënat se si komunat e bëjnë vlerësimin e tregut gjatë fazës së planifikimit të prokurimit.

Mënyra se si komunat e vlerësojnë tregun gjatë procesit të planifikimit ⁷⁴				
Komuna	Dalje në terren	Nga prokurimet paraprake të njëjta ose ngjashme	Është përgjegjësi e njësisë kërkuese	Tjera
Deçan			√	
Gjakovë			√	
Gjilan		√		
Hani i Elezit	√			
Junik		√		
Pejë			√	
Prishtinë			√	
Rahovec			√	
Vushtrri		√		

Tabela 29: Mënyra se si komunat e vlerësojnë tregun gjatë procesit të planifikimit⁷⁵

Gjatë intervistave lidhur me vlerësimin e tregut, përveç tjerash vihet në pah edhe mungesa e një bashkëpunimi adekuat ndërmjet njësisë të kërkesës dhe zyrave të prokurimit të komunave.

⁷⁴ Sqarim: Në kolonën ku është i vendosur simboli (√) do të thotë që komuna vlerësimin e tregut e bënë duke u mbështetur në atë indikator të vlerësimit.

⁷⁵ Burimi: Intervistat me zyrtarët e prokurimit të komunave.

Kjo mund të vërehet edhe në tabelën më lart ku nga nëntë zyrtar të prokurimit, pesë prej tyre thonë se kjo është përgjegjësi e njësisë së kërkesës. Bashkëpunimi i tyre nuk është vetëm një e mirë për autoritetin kontraktues por është edhe obligim ligjor, sepse sipas nenit 10, paragrafi I, pika (d) e RrUOPP “Njësia e Kërkesës, e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, ka përgjegjësitë në vijim (d) Të bashkëpunojë me dhe të asistoj departamentin e prokurimit gjatë procesit të prokurimit”⁷⁶.

Plani i prokurimit ku bënë pjesë edhe vlerësimi i tregut bien nën përgjegjësinë e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, ku i njëjti në bashkëpunim me të gjitha departamentet e harton një plan të tillë, në bazë të nenit 11, par 1, lidhur me pikën (a) të RrUOPP “[z]yrtari përgjegjës i prokurimit është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP, përveç obligimeve tjera ka përgjegjësitë në vijim: a) në konsultim me të gjitha departamentet përgatit një plan vjetor të prokurimit.”

Pra, bashkëpunimi i këtyre dy njësisë është i domosdoshëm në mënyrë që autoriteti kontraktues të zhvillojë procedura të prokurimit në mënyrë profesionale, rrjedhimisht edhe plani i prokurimit t’i pasqyrojë nevojat reale të komunës e jo të krijohen situata kur duhet të anashkalohet ky plan, siç ka ndodhur në shumë raste të cekura në raport.

15. Gjetjet lidhur me procesin e planifikimit të prokurimit

- Asnjëra nga komunat e monitoruara, planifikimin e prokurimit nuk e ka hartuar në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.
- Nga komunat e monitoruara, vetëm komuna e Rahovecit nuk e ka dërguar në AQP planifikimin përfundimtar të prokurimit brenda afateve të parapara me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. E njëjta Planin e ka dërguar në AQP para miratimit të buxhetit për vitin 2020.
- Komunat nuk e përdorin Formularin B01 të aprovuar nga KRPP për planifikim të prokurimit, si pasojë e dështimit të KRPP-së që të njëjtin ta adaptojë në platformën elektronike e-prokurimi.
- Nga nëntë komunat e monitoruara, asnjëra komunë nuk e ka plotësuar planin e prokurimit në bazë të kërkesave ligjore, përkatësisht të dhënat për aktivitetet e furnizimeve nuk janë të plota dhe të sakta.
- Komuna e Pejës, Prishtinës dhe Vushtrrisë, në plan të prokurimit për aktivitetet e furnizimeve nuk e kanë asnjë detaj tjetër përpos emrit të aktivitetit, datës së planifikuar për inicim dhe vlerës së parashikuar.
- Komuna e Gjilanit, Hanit i Elezit, Junikut, Rahovecit dhe Vushtrrisë, kanë inicuar aktivitete për furnizim jashtë planit të prokurimit.
- Nga pesë aktivitetet e monitoruara për furnizim, përjashtuar dy raste/aktivitete në Komunën e Junikut dhe një në Komunën e Rahovecit, në asnjërin nga komunat njësitë dhe sasitë e planifikuara tek aktivitetet për furnizim nuk janë identike me njësitë dhe

⁷⁶ Shih, neni 10, RrUOPP, <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/A01%202019/Rregullat%20dhe%20Udhhezusi%2010%2004%202019%202.pdf>.

sasitë gjatë fazës tenderuese. Ato ose ndryshojnë shumë për nga vlera ose nuk kanë të bëjnë fare me aktivitetin përkatës të planifikuar.

- Përveç Komunës së Deçanit, asnjëra nga komunat tek kontratat për furnizim nuk i kanë qëndruar prapa vlerës së parashikuar të aktiviteteve për furnizim, respektivisht vlerat e parashikuara janë të ndryshme në mes të planit të prokurimit dhe njoftimeve për kontratë.
- Komuna e Gjilanit, Hanit të Elezit dhe Rahovecit, tek aktivitetet për furnizim në pjesën ku është dashur të vendoset sasia dhe njësia, kanë përdorur shabllone të ndryshme vetëm për ta mbushur kolonën.
- Komuna e Gjakovës, Gjilanit dhe Pejës, gjatë fazës tenderuese tek aktivitetet për furnizim kanë përdorur njësi matëse të panjohura dhe joadekuate.
- Asnjëra nga komunat, vlerat e parashikuara të aktiviteteve për punë nuk i ka të njëjta me kapacitetet buxhetore të ndara për ato aktivitete. Përveç Komunës së Vushtrrisë që ka më shumë mjete buxhetore se sa aktivitetet për punë të planifikuara, komunat tjera kanë planifikuar shumë më shumë se sa që kanë mjete në dispozicion.
- Përrjashtuar Komunën e Vushtrrisë, në komunat tjera janë evidentuar aktivitete të planifikuara për punë që nuk mund të identifikohen në buxhetin e vitit 2020.
- Nga komunat e monitoruara, vetëm Komuna e Deçanit asnjërin nga aktivitetet e inicuarat për punë me kohëzgjatje 1-3 vite nuk e ka të parashikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022.
- Përveç komunës së Deçanit për arsyet e cekura më lart, në asnjërin nga komunat vlerat e parashikuar në njoftimin për kontratë, të aktiviteteve për punë me kohëzgjatje 1-3 vite, nuk përputhen me vlerat e parashikuara në Kornizat Afatmesme Buxhetore të komunave, pra, vlerat janë të ndryshme.
- Komuna e Pejës, Gjilanit dhe Prishtinës, aktivitetet për punë i kanë të vendosura në kode të përgjithshme buxhetore, përkatësisht në një kod shumë aktivitete dhe për pasojë identifikimi i tyre është i pamundur.
- Nga intervistat e zhvilluara, rezulton se asnjëra nga komunat nuk bënë një analizë të mirëfilltë të tregut gjatë planifikimit, përkatësisht caktimit të vlerës së parashikuar të aktiviteteve.
- Komunat gjatë analizimit të tregut fokusohen ose në dalje në terren ose në prokurimet e kaluara pa i analizuar të dyja bashkë apo edhe shtuar ndonjë mënyrë tjetër të vlerësimit, gjë që vërehet nga ndryshimi i vlerave të parashikuara gjatë inicimit të aktiviteteve.
- Njësitë kërkuese dhe zyrat e prokurimit nuk kanë një komunikim të duhur, respektivisht mungon bashkëpunimi i duhur gjatë të gjitha fazave të prokurimit.

16. Rekomandime

- Komunat të hartojnë planin e prokurimit në bazë të kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe Formularit B01.
- Komuna e Rahovecit Planin përfundimtar të prokurimit ta dorëzojë në AQP brenda afateve të parapara me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

- KRPP të sigurohet që formulari B01 të adaptohet në platformën elektronike e-prokurimi, në mënyrë që komunat planifikimin ta kenë në përputhje me këtë formular.
- Komunat të sigurohen që planet e prokurimit t'i përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme, përkatësisht tek aktivitetet për furnizim, sasitë dhe njësitë të jenë të sakta, ndërsa komunat që fare nuk i kanë të vendosura këto të dhëna, të kujdesen që në të ardhmen të njëjtat t'i vendosin konform kërkesave ligjore. Komuna e Gjilanit, Hani i Elezit, Junikut, Rahovecit dhe Vushtrrisë të sigurohen që aktivitetet e inicuarra për furnizim të jenë të planifikuara me plan të prokurimit.
- Tek kontratat për furnizim, komunat të sigurohen që njësitë dhe sasitë e paraqitura në plan të prokurimit të jenë të njëjta me sasitë dhe njësitë gjatë fazës tenderuese.
- Përveç Komunës së Deçanit, komunat e tjera të kujdesen që vlerat e parashikuara të kontratave për furnizim t'i kenë të njëjta edhe gjatë fazës tenderuese.
- Komuna e Gjilanit, Hanit të Elezit dhe Rahovecit, tek aktivitetet për furnizim në pjesën ku duhet të vendoset sasia dhe njësia të mos përdoren shabllonet të cilat fare nuk kanë të bëjnë me aktivitetin në fjalë, përkatësisht të mos përdoren sasi apo njësi matëse vetëm sa për t'i mbushur kolonat.
- Komuna e Gjakovës, Gjilanit dhe Pejës të kujdesen që gjatë inicimit të aktiviteteve për furnizim të përdoren njësi matëse adekuate.
- Komunat të sigurohen që planifikimet që i bëjnë të kenë mbulueshmëri në buxhet, përkatësisht kosto e aktiviteteve të planifikuara për punë të jetë e njëjta edhe në buxhet, respektivisht të mos jetë më e lartë si në komunat: Deçan, Gjakovë, Gjilan, Hani i Elezit, Junik, Pejë, Prishtinë dhe Rahovec, ose më e ulët si në Komunën e Vushtrrisë.
- Përveç Komunës së Vushtrrisë, komunat tjera të sigurohen që projektet e planifikuara për punë të jenë edhe në buxhetin për vitin përkatës fiskal.
- Komunat të kujdesen që projektet për punë me kohëzgjatje 1-3 vite të jenë në përputhje me Kornizat Afatmesme Buxhetore të Komunave.
- Komuna e Pejës, Gjilanit dhe Prishtinës, të mos e përdorin praktikën që në buxhet të vendosin kode buxhetore të përgjithshme për aktivitetet për punë, nga ku pastaj financohen projekte të ndryshme.
- Komunat të bëjnë një analizë të mirëfilltë të tregut duke marrë parasysh të gjitha elementet e rëndësishme në mënyrë që planifikimi i vlerës së kontratës të jetë sa më i saktë me vlerën reale.
- Komunat gjatë analizimit të tregut të mos fokusohen vetëm tek dalja në teren ose kontratat e mëparshme, mirëpo të konsiderojnë gjithmonë që të dyja dhe gjithashtu të shikojnë manualet për çmime referente të publikuara nga KRPP dhe çdo mundësi tjetër që sjellë rezultate të një planifikimi real.
- Të rritet bashkëpunimi i njësive kërkuese dhe zyra të prokurimit në secilën fazë të prokurimit sepse edhe ligjërisht obligohen që ta asistojnë njëra-tjetrën.

17. Aneks I : Komentet e komunave të cilat nuk janë përfshi në raport

17.1. Komuna e Hanit të Elezit

Nr.	Komenti i Komunës	Sqarimi i IKD dhe INPO
1	<p>Po me befason fakti qe thoni se nuk është në Plan aktiviteti (Furnizimi me dezinfektues, maska dhe doreza), se si duhet të jenë në Plan prokurimet emergjente, sepse emergjenca nuk dihet qoftë pandemi, zjarr, vërshim, p.sh. Nuk mund të planifikohet pandemia.</p>	<p>Metodologjia e raportit ka qenë që të monitorohen pesë (5) aktivitetet e para për furnizim që ka inicuar komuna e caktuar gjatë vitit 2020. Lidhur me aktivitetin për furnizim i cili nuk është identifikuar në Plan të prokurimit dhe që sipas komentit tuaj është proceduar urgjente si pasojë e pandemisë COVID-19, ne kemi sqaruar këtë fakt edhe në raport (përshkrimi i tabelës numër 7), mirëpo është fakt i pakontestueshëm që projekti në fjalë bënë pjesë në pesë aktivitetet e para për furnizim dhe i njëjti nuk është në Plan të prokurimit, ndërsa arsyet sigurisht mund të jenë të ndryshme. Pra, ne nuk kemi paragjykuar arsyen, thjeshtë është identifikuar se aktiviteti në fjalë nuk ka qenë në plan të prokurimit.</p>
2	<p>Te gjitha aktivitetet janë në Plan të prokurimit 2020 e të cilat IKD dhe INPO deklarojnë se nuk janë, përveç një procedure “Maska dhe doreza” që është procedure emergjente për shkak se procedurat emergjente nuk planifikohen, p.sh. Nuk është planifikuar Pandemia!</p>	<p>Aktivitetet "Furnizime me pije për Zyrën e kryetarit, kuvendit komunal, administratën komunale" dhe "Furnizime me pajisje për kabinete", nuk gjenden në plan të prokurimit i shkarkuar me 06.04.2020 nga Platforma e-prokurimi. Ky Plan është plan zyrtar i ngarkuar në platformën elektronike e-prokurimi.</p> <p>Është e vërtetë që në rishikimin e Planit të prokurimit, Komuna e Hanit të Elezit i ka përfshirë këto aktivitete, mirëpo për këto aktivitete të cilat IKD dhe INPO i kanë evidentuar që nuk janë në Plan, ka vlejtur Plani i parashikuar, pra Plani përfundimtar fillestar i shkarkuar më 06.04.2020. Argument për këtë është se aktiviteti "Furnizim me pije për zyrën e kryetarit, kuvendit komunal, administratës komunale" është inicuar me 13.02.2020, shih aktivitetin me numër të prokurimit: 659-20-361-1-3-6, ndërsa aktiviteti "Furnizim me pajisje</p>

		<p>për kabinete" është publikuar me 23.06.2020, shih aktivitetin me numër të prokurimit 659-20-3023-I-3-6. Pra, këto aktivitete janë inicuar para se të bëhet rishikimi i planit të prokurimit, madje para lajmërimit të lejueshmërisë së një rishikimi të tillë nga KRPP dhe AQP.</p> <p>Tutje, nga asnjë dispozitë ligjore nuk mund të nxjerrim atë se ndryshimi i planit ka efekt retroaktiv, përkatësisht që efekti i tij shtrihet edhe në prokurimet që veçse kanë ndodhur apo janë lidhur kontratat për to.</p>
3	<p>Lidhur me sasi të "kont", ju sqarojmë se nuk mund të shkruhen 300-400 artikuj për një procedure në Plan të prokurimit sepse kjo është e tepërt dhe me siguri një plan i prokurimit do të duhet të punohet më shumë se 3 apo 6 muaj në të!</p>	<p>Sa i përket shabllonit "kont", mendojmë që nuk qëndron si argument sepse kërkesat e LPP-së, neni 8, lidhur me nenin 5 të RrUOPP dhe Formulari B01 i aprovuar nga KRPP, kërkojnë që aktivitetet e furnizimeve të planifikohen në mënyrë të detajuar, përfshirë këtu sasi dhe njësitë. Gjithashtu, arsyeja se do të merrte kohë nuk qëndron sepse të njëjtat sasi dhe njësi (pra të sakta) ne i kemi evidentuar nga dokumenti paramasa/lista e çmimeve. Rrjedhimisht, Njësia Kërkuese në bashkëpunimin me Zyrën e Prokurimit, është e obliguar që sasi dhe njësitë të planifikohen me detaje sipas kërkesave ligjore, ashtu sikur janë planifikuar dhe saktësuar gjatë fazës së inicimit</p>
4	<p>Lidhur me projektin "Mirembajtja dhe riparimi i ndërtesave", me vlerë 22,000 €, ju sqarojmë se është në Planin e prokurimit, nr.26 të Planit (Mirembajtja dhe riparimi i ndërtesave).</p>	<p>IKD dhe INPO në këtë raport kanë thënë se aktiviteti "Mirembajtja dhe riparimi i ndërtesave", me vlerë 22,000€, nuk është në buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020, e jo në plan të prokurimit. Pra, është e vërtetë që ky aktivitet është në plan të prokurimit dhe ne këtë nuk e kemi pohuar apo mohuar.</p>
5	<p>Lidhur me projektet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - "Ndertimi i shtepise se kultures Imri Curri - Hani i Elezit (faza e dyte)" me vlere 499,983.00 €; - "Ndertimi i salles se sporteve ne SHFMU. "Veli Ballazhi" ne Han te Elezit me vlere 324,000.00 €. 	<p>Lidhur me aktivitetet e prokurimit të cilat janë krahasuar me KAB, përkatësisht projekti "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Imri Curri-Hani i Elezit(faza II)" dhe "Ndërtimi i sallës së sporteve në SHFMU"Veli Ballazhi".</p>

<p>Ne si zyre ju sqarojmë: Buxheti dihet mirëpo ne si Komunë, varësisht marrëveshjeve që i kemi me Ministrinë dhe periudhën kohore për ekzekutim e planifikojmë. Pra, sa për njoftim se vlera e donacionit nuk del në buxhetin vjetor dhe ne i vendosim mjetet në buxhet vetëm sa kemi në dispozicion.</p> <p>Komente shtesë: Te projekti “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Imri Curri - Hani i Elezit (faza e II), shtojë edhe disa sqarime se kur është miratuar buxheti për vitet 2021-2023 ne kemi paraparë buxhet për ta mbuluar projektin në tërësi edhe për 320,000.00€ që mund ta gjeni në ligjin e buxhetit për vitin 2021 të miratuar.</p> <p>Te projekti “ Ndërtimi i sallës së sporteve ne SHFMU. Veli Ballazhi ne Gorance”, përveç mjeteve tona që kemi pasur, ne kemi pasur ri-alokim dhe transfer të mjeteve që mjete te paguara nga buxheti i komunës kanë qenë në shumë prej afro 180,000.00€, pastaj edhe disa donacione si: donacion nga MZHR në shumë prej 50,000.00 €, pastaj nga DEMOS në shumë prej 49,315.00 € dhe pjesa e mbetur për ta përfunduar këtë projekt janë paraparë me buxhetin e vitit 2021 në shumë prej 45,000.00 €.</p>	<p>Sqarim: Vlerat ashtu siç janë në paraqitur në raport të njëjtat janë edhe në KAB 2020-2022 të Komunës së Hanit të Elezit, ndërsa sa i përket donacioneve, ne këtë çështje e kemi shpjeguar në raport tek përshkrimi i tabelës numër 24. Për korrektësi po e citojmë përshkrimin e tabelës numër 24 "Lidhur me këto gjetje menaxheri i Zyrës së Prokurimit z. Xhevdet Bushi ka shpjeguar se ky dallim ka ndodhur për faktin se fillimisht janë paraparë ato vlera, ndërsa gjatë detajizimit të projekteve është parë se kushtojnë më shumë dhe janë vendosur këto vlera, parat janë siguruar nga rialokime dhe transfere nga projektet e tjera, gjithashtu ka pasur donacion nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe DEMOS". Pra, ne e kuptojmë se si ka lindur problemi apo ndryshimi, po ashtu e kemi vendosur në raport, mirëpo është i pakontestueshëm fakti se këto dallime qëndrojnë dhe në të ardhmen komuna duhet të sigurohet që këto probleme të evitohen.</p> <p>Gjithashtu, në këtë kapitull ne nuk kemi thënë askund që këto projekte nuk janë në buxhet të komunës, mirëpo është analizuar se sa respektohet KAB-i nga ana e komunave, përkatësisht vlera e parashikuar e një aktiviteti për punë e paraqitur në KAB a është e njëjtë apo e përafërt edhe në momentin kur aktiviteti në fjalë inicohet nga komuna.</p>
---	---

17.2. Komuna e Junikut

Nr.	Komenti i Komunës	Sqarimi i IKD dhe INPO
I	E gjetura në faqen 24, pjesa e II- të nuk qëndron dhe konsideroj se duhet të largohet nga Draft Raporti sepse aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizim me klima për objektin e QKMF- së” ka ardhur si kërkesë urgjente nga Njësia e Kërkesës për t’iu krijuar kushtet pacientëve të QKMF- së, andaj në rast të kërkesave të	Në bazë të metodologjisë së raportit ne i kemi monitoruar pesë (5) aktivitetet e para për furnizim që i ka inicuar Komuna e Junikut në vitin 2020. Në mesin e pesë (5) aktiviteteve të para bënë pjesë edhe aktiviteti "Furnizim me klima për objektin e QKMF". Pra, i njëjti nuk mund të largohet nga raporti sepse

domosdoshme në raste të jashtëzakonshme siç është periodha pandemike për sigurimin e kushteve të tilla lejohet një furnizim i tillë edhe nëse ai furnizim është jashtë planifikimit të prokurimit.

bënë pjesë në pesë (5) aktivitetet e para që ka inicuar Komuna Juaj, mirëpo ashtu siç e shihni në raport ne kemi sqaruar, përkatësisht kemi përfshirë komentin tuaj, po e citojmë siç është e shkruar në raport "Lidhur me këtë çështje, Udhëheqja e Prokurimit znj. Florinda Maloku është përgjigjur se "Njësitë e Kërkesës nuk e kanë paraparë si aktivitet primar" dhe se kjo ka ardhur si pasojë e pandemisë Covid 19 për të krijuar kushte më të mira për staf dhe pacient".

Andaj ky sqarim ka qenë i përfshirë në raport në bazë të intervistave të më hershme.